

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**


**Për Programin e studimit BSc në Drejtësi**

**Kolegji Universitar "Wisdom"**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Dr. Erind Merkuri

Prof. Asoc. Dr. Mirela P. Bogdani



Qershor, 2017


## **RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Për Programin e studimit BSc në Drejtësi**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	SH.L.U.J 'Wisdom University'
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Drejtësisë i SH.L.U.J 'Wisdom University'
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Licensuar nga VKM, Nr. 254, datë 27.2.2008 Riorganizuar nga Këshilli i Akreditimit me vendimin Nr. 214, datë 29.07.2011 si dhe me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 412, datë 25.08.2011.
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	Vendim Nr. 150, 18.02.2011 të Këshillit të Akreditimit të APAAL dhe Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 188, 25.04.2011
5	Titulli i programit të studimit:	BSc në Drejtësi
6	Cikli i studimit:	Parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Studime me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
11	Programi ofrohet nga institucioni	Bsc në Drejtësi
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucionet tjetra	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6 (gjashtë)
16	Numri i studentëve aktualë	145 studentë
	Etj	

**Shënim:**

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim



## **HYRJE**

### **Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Drejtësi**

Programi Bachelor në Drejtësi në Kolegjin Universitar Wisdom është hapur bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.254, datë 27.2.2008 "Për hapjen e programeve të tjera studimi pranë Shkollës së Lartë Universitare private "Wisdom University".

Këshilli i Akreditimit me Vendimin nr.150, datë 18.2.2011 "Për akreditimin e Programeve të Studimit që përfundojnë me Diplomë e Nivelit të Parë/Bachelor në "Drejtësi" dhe Diplomë e Nivelit të Parë/Bachelor në "Psikologji", të Shkollës së Lartë Universitare Private "Wisdom University", ka dhënë vlerësimin përfundimtar pozitiv për akreditimin e programit Bachelor në Drejtësi, por njëkohësisht duke lënë shtatë rekomandime për t'u ndjekur dhe plotësuar nga ky Kolegj.

Bazuar në vendimin e mësipërm Ministri i Arsimit dhe Shkencës me Urdhërin nr.188, datë 25.4.2011 (nr.1178/3 prot., datë 25.4.2011) "Për akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Drejtësi" dhe "Psikologji" të Shkollës së Lartë Universitare Private "Wisdom University", ka vendosur akredimin e programit Bachelor në Drejtësi, si edhe plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga Këshilli i Akreditimit në vendimin e tij nr.150, datë 18.2.2011.

### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ:

1. Dr. Erind Merkuri
2. Prof. Asoc. Dr. Mirela P. Bogdani

Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u shoqërua nga Specialistja e ACSAL. Znj Suela Kromidha

Më datë 03.07.2017 në Institucion dërgohet Draft RVJ. Më datë 05.07.2017 vjen përgjigja nga Institucioni I cili është Ok me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm dhe nuk ka asnjë koment mbi këtë Draft.

Për këtë Arsy, Draft rapporti merr formën e tij përfundimtare si Raport I Vlerësmit të Jashtëm.

### **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË**

#### **I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

- Të vlerësohet mundësia e rritjes së kontakteve edhe me universitete të tjera, vendase dhe të huaja, publike dhe private, në mënyrë të veçantë europiane dhe amerikane që ofrojnë sidomos studime në Psikologji për të qenë në korrent të ndryshime që pëson kurrikula e kursit në përshtatje me kërkeshat e tregut të punës (mundësisht të ketë një marrëveshje bashkëpunimi me fokus programet e studimeve në Psikologji me Universitetin e Tiranës).


- Të rishikohen kriteret e punësimit të pedagogëve të rinj me synim nxitjen dhe mbajtjen e tyre në punë për afate të gjata kohore. Nxitja dhe inkurajimi i tyre mund të vijë përmes krijimit të mundësive për specializime brenda dhe jashtë vendit si dhe nëpërmjet një angazhimi më të plotë në punët e universitetit.
- Të shihet mundësia e vendosjes së kritereve seleksionuese në pranimin e studentëve në programet e studimit Bachelor. Kjo do të ndikonte në rritjen e cilësisë.
- Të shihet mundësia e pasurimit të fondit të bibliotekës me botime në gjuhën shqip dhe në gjuhë të huaja sipas fushave të studimit.
- Të shihet mundësia e organizimit të një jete më aktive dhe të gjallë të studentëve pas mësimit.
- Është imediate zgjidhja e çështjes së kampusit të universitetit që do t'i jepte një vlerë më të madhe këtij institucioni.
- Duhet të shihet mundësia e ngritjes së një klinike për punën me studentët.

## **II. Plotësimi i Rekomandimeve nga Institucioni**

Lidhur me Rekomandimet që Këshilli i Akreditimit i ka lënë Institucionit/Kolegit Universitar 'Wisdom' në akreditimin e parë, gjatë vizitës në institucion si dhe gjatë takimeve të zhvilluara me autoritetet drejtuese, me pedagogët, studentët dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, bazuar edhe nga inspektimi i dokumentacionit dhe vizita në ambientet e institucionit, rezultoi se janë marrë masa pozitive dhe stafi ka punuar seriozisht për të plotësuar të gjitha rekomandimet.

Lidhur me rekomandimin e parë 'vlerësimi i mundësisë së rritjes së kontakteve edhe me universitete të tjera, vendase dhe të huaja, publike dhe private' u konstatua se janë nëshkruar marrëveshje me institacione arsimore (IAL) vendase dhe të huaja si dhe janë zhvilluar aktivitete konkrete, përfshirë këtu edhe zhvillimin e leksioneve nga pedagogë të huaj për periudha 2-3 javore, ndaj vlerësohet se ky rekomandim është përbushur. Sugjerohet që këto bashkëpunime të vazhdojnë edhe në të ardhmen dhe të shtrihen edhe me institacione të tjera për sa do të jetë e mundur, dhe të reflektohen edhe në faqen e internetit të institucionit në mënyrë që të krijojnë impakt tek studentët apo edhe në komunitet.

Lidhur me rekomandimin e dytë 'rishikimi i kritereve të punësimit të pedagogëve të rinj me synim nxitjen dhe mbajtjen e tyre në punë për afate të gjata kohore' u konstatua se institucioni dhe departamentet janë të motivuar jo vetëm të punësojnë pedagogë të kualifikuar që kanë kapacitetin akademik (tituj dhe gradat) por fokusohen edhe në ndihmesën konkrete që i kanë dhënë pedagogëve të rinj për të plotësuar kriteret e kualifikimeve shkencore duke përfshirë mundësinë për pjesëmarrje në konferanca, mundësinë për të botuar, si dhe uljen e ngarkesës mësimore. Gjithashtu u konstatua se



pjesa më e madhe e stafit janë pedagogë që janë përfshirë në procesin e mësimdhënies në BSc në Drejtësi që në krijimin e Kolegit dhe kanë një eksperiencë të gjatë si profesionale ashtu edhe në mësimdhënie. Në këtë kontekst edhe ky rekomandim është plotësuar.

Lidhur me rekomandimin e tretë 'krijimi/rishikimi i mundësive për të vendosur kriterë seleksionuese në pranimin e studentëve në programet e studimit Bachelor në funksion të rritjes së cilësisë' u konstatua se kriteret për pranimin e studetëve janë bazuar tek Ligji Nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë'; Ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, 'Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi të nxjerra nga MAS. Përpos kritereve ligjore të sipërcituara, Institucioni/Kolegji në RVB pretendon se ka vendosur dhe kriterë shtesë. Më konkretisht në RVB pretendohet se për vitin akademik 2016-2017 me Vendim Senati nr. 16, dt. 15.02.2016 me Nr. 137 Prot. ka miratuar këto kriterë shtesë. Për programet e studimit të ciklit të pare "Bachelor", si më poshtë: 1. Nota mesatare e shkollës së mesme, (për të gjithë vitet) do të përbëjë 70% të vlerësimit përfundimtar. 2. Nota mesatare e grup lëndëve të vlerësuara si më të rëndësishme nga Komisioni Përzgjedhës, adhoc, i cili ngrihet për çdo njësi kryesore, do të zërë 20 % të vlerësimit përfundimtar. 3. Intervista me çdo kandidat, e organizuar nga Komisioni Përzgjedhës, ad-hoc, do të zërë 10% të vlerësimit përfundimtar, ndërsa për vitin akademik 2016-2017 për programin "Bachelor në Drejtësi" ka miratuar këto kriterë: 1. Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore, minimale 6, do të përbëjë 40% të vlerësimit përfundimtar. 2. Mesatarja e lëndëve: Filozofi, Qytetari, Sociologji, Histori, Gjuhë shqipe dhe Letërsi, do do të përbëjë 40% të vlerësimit përfundimtar. 3. Intervista me çdo kandidat, e organizuar nga Komisioni Përzgjedhës, ad-hoc, do të zërë 20% të vlerësimit përfundimtar. Nga analiza e këtyre momenteve, rezulton që me vendim të Senatit është rregulluar mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve për studentë, por nuk rezulton që të jenë vendosur kriterë shtesë, tej atyre të përcaktuara me akte nënligjore. Në këtë këndvështrim arritëm në përfundimin se ky rekomandim nuk është plotësuar.

Lidhur me rekomandimin e katërt 'mundësia e pasurimit të fondit të bibliotekës me botime në gjuhën shqip dhe në gjuhë të huaja sipas fushave të studimit' u konstatua se Kolegji ka bërë përpjekje seriozë për të pasuar fondin e bibliotekës me botime në gjuhën shqipe. Sipas të dhënave të administruara rezulton se për vitin akademik 2015-2016, si libra të rinj rezulton se janë blerë 32 tituj, ndërsa për vitin akademik 2016-2017, si libra të rinj rezulton se janë blerë 15 tituj. Po kështu, rezulton se nga ana e Kolegit Universitar është bërë edhe abonimi në bibliotekën elektronike ProQuest. Kjo bibliotekë elektronike përmban një inventar prej 10162 tituj librash, format PDF, e cila përditësohet vazhdimesht. Përpos kësaj, sic përshkruhet përgjatë Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, u konstatua një tendencë dhe interes për të studiuar në thellësi, çështje që lidhen me vlerat, historinë dhe

trashëgiminë e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri (në këtë kuadër vlen të përmendet monografia në proces botimi me titull 'Trashëgimia Institucionale e Shqipërisë prej antikitetit deri në vitin 1920', një studim i bazuar mirëfilli mbi dokumenta dhe hulumtime të kryera për herë të parë, një punim që u vlen jo vetëm studentëve të Kolegit, por edhe të gjithë juristëve, historianëve dhe çdo qytetari që ka interes të njohë zhvillimin e kombit tonë), ndaj arritëm në përfundimin se edhe ky rekomandim është plotësuar.

Lidhur me rekomandimin e pestë 'mundësia e organizimit të një jete më aktive dhe të gjallë të studentëve pas mësimit' u konstatua se studentët kanë filluar të organizohen në forume apo klube ku diskutojnë çështje të ndryshme ligjore dhe kanë organizuar udhëtime dhe aktivitete të përbashkëta argëtuese. Gjatë takimit me studentët u konstatua se edhe ata janë të motivuar të organizohen dhe kanë pasur mbështetjen e Kolegit për këtë qëllim; kjo gjë u reflektua edhe nga takimi me pedagogët dhe dëshira e tyre për të përfshirë studentët në aktivitete profesionale dhe shkencore, leksione të hapura por edhe për t'i asistuar ata në kërkuesat dhe interesat e tyre për të realizuar aktivitete. Ne arritëm në përfundimin se edhe ky rekomandim është plotësuar.

Lidhur me rekomandimin e gjashtë 'zgjidhjen e çështjes së kampusit', gjatë vizitës në institucion u konstatua së mjeshterit e reja të Kolegit ishin tejet të përshtatshme për procesin mësimor, kishte mjaftueshëm salla leksioni dhe seminaresh të pajisuar edhe me teknologji bashkëkohore, ambiente për pedagogët, bibliotekën, ambiente shplodhëse për studenët, kishte hapësira të gjelbëruara dhe mundësi parkimi, ndaj arritëm në përfundimin se edhe ky rekomandim është plotësuar plotësisht.

Lidhur me rekomandimin e shtatë 'ngritjen e një Klinike për punën më studentët' u informuam dhe konstatuam se është krijuar Klinika Ligjore e Kolegit, megjithatë është në fazat e para të veprimtarisë së saj, e për rrjedhojë nuk ka arritur të krijojë synimin e vendosur për të realizuar aspektin praktik të punës me studentët apo edhe këshillim logor *pro bono*. Në këtë kontekst, rekomandimi është plotësuar pjesërisht, ndaj sugjerojmë që drejtuesit e programit BSC në Drejtësi të angazhojnë ekspertë në ngritjen e kapaciteteve të Klinikës Ligjore për ta bërë atë funksionale dhe në shërbim praktik të studentëvë të ciklit të parë por edhe për programet e ciklit të dytë, dhe pse jo edhe në shërbim të komunitetit me asistencë ligjore *pro bono* për kategori qytetarësh që nuk kanë mundësi të përballojnë finansiarisht kostot e një procesi ligjor.

## **ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **1. Misioni/Objektivat e programit të studimit**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Kolegji Universitar 'Wisdom', bazuar në vizitën në institucion si dhe në materialet e konsultuara, rezulton të reflektojë një vizion të qartë lidhur me Misionin dhe Objektivat e programit BSc në Drejtësi. Që në përballjen e parë me faqen e internetit të Kolegit<sup>1</sup>, paraqitet synimi kryesor i tij, i fokusuar tek '*zhvillimi i arsimit dhe shkencës, në shërbim tē lirisë e diversitetit tē ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për zhvillimin e ekonomisë, për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor, tē realizuara me veprimtari tē ligjshme dhe transparente*'. Lidhur me këtë, Kolegji ka miratuar Rregulloren e Shkollës së Lartë Universitare Jo-Publike 'Wisdom University' në mbledhjen e Senatit të datës 02.11.2011. Kjo rregullore, ndonëse e përgjithshme, vlen edhe për programin e Fakultetit të Drejtësisë (*Për më shumë shiko Dispozitat e Përgjithshme tē Rregullores*). Në rregullore nuk parashikohet në mënyrë eksplikite cili është misioni dhe vizioni apo objektivat institucionit, përfshirë këtu edhe misioni dhe vizioni i programit BSc në Drejtësi, megjithatë përgjatë saj reflektohet synimi i tij për t'u ofruar studentëve dije bashkëkohore dhe cilësi në mësimdhënie.

Gjithashtu Institucioni ka miratuar edhe 'Rregulloren për organizimin e Programit të Studimeve, të Ciklit të Parë, Bachelor në Drejtësi, për vitin akademik 2016-2017; Neni 4 i saj parashikon parimet mbi bazën e të cilave do të zhvillohet procesi mësimor, bazuar në:

- *lirinë akademike*
- *autonominë institucionale dhe*
- *rritjen e vazhdueshme tē cilësisë në mësimdhënie*

Përveç këtyre elementëve, vihet re edhe një tendencë e Kolegit për tē ofruar krahas dijeve me karakter teorik edhe module të natyrës praktike. Kjo parashikohet nga konceptimi i Praktikës Mësimore në vitin e tretë tē studimeve (*për më shumë shiko Neni 8 i Rregullores*).

Kolegji, në mënyrë tē përgjithshme gjithashtu ka artikuluar, kjo reflektuar edhe vizualisht në faqen e tij të internetit objektivat e tij afatshkurtër, afatmesëm, dhe ato afatgjata gjë që

---

<sup>1</sup> Për më shumë informacion shiko Misioni & Vizioni i Kolegit Universitar 'Wisdom' - <http://www.wisdom.edu.al/misionivizioni>



ndikon në një zhvillim të qëndrueshëm të planifikuar e të mirëmenduar përgjatë zhvillimit të programit, por edhe më pas në vijimin e studimeve në ciklin e dytë apo përgatitjen pëtregun e punës të studentëve që diplomohen.

Vlerat që Kolegji kërkon të transmetojë nëpërmjet dijes në programin BSc në Drejtësi fillojnë strukturohen që në momentin e parë të kontaktit të studentin me procesin e orientimit të studentit - për këtë qëllim është përgatitur Guida e Studentit<sup>2</sup>, një dokument i mirë-strukturuar dhe i plotë dhe i detajuar në informacion.

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standaret/kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programet e studimit BSc në Drejtësi janë hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe objektivat afatshkurtra, afatmeseme dhe afatgjata, pasi reflektojnë modulet kryesore të formimit të studentit në disiplinën/shkencën e së drejtës si dhe module plotësuese të lëndëve me zgjedhje, që i plotësojnë interesat e tyre në varësi të profileve dhe temave specifike.
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	Programet e studimit BSc në Drejtësi, nga verifikimet që ju bënë si dhe nga takimet e zhvilluara në institucion/Kolegj me pedagogë dhe studentë (përfshirë edhe studentë të cilët ishin diplomuar nga ky program) reflektojnë objektiva të artikuluara qartë, që lidhen plotësisht me profilin e programit, duke mundësuar mësim-dhëni dhe mësim-nxëni me kompetencë profesionale.
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Programet e studimit BSc në Drejtësi ofrojnë një formim të përgjithshëm të studentit në module që reflektojnë kryesisht ndarjet e së drejtës në fushën publike, civile dhe atë penale - kjo u mundëson studentëve përshtatjen lehtësisht në programe të mëtejshme të avancuara studimi të ciklit të dytë e më tej, si në Shqipëri edhe jashtë. Formimi i përgjithshëm në këtë program krijon lehtësi përshtatje edhe në tregun e punës, megjithatë në Shqipëri mungojnë të dhënat e sakta e të plota në nivel institucionesh shtetërore për kërkessat e tregut të punës, dhe konsiduar edhe faktin që shumica e studentëve që mbarojnë studimet BSc vazhdojnë edhe më tej programe të ciklit të dytë, arrijmë natyrshëm në përfundimin që është e vështirë të realizosh në terrenin shqiptar një analizë të saktë e të plotë të nivelit të suksesit të kurrikulave të një programi që ofrohet.

<sup>2</sup> Për më shumë shiko [http://Wisdom.edu.al/pdf/Guida\\_e\\_Studentit\\_2016-2017.pdf](http://Wisdom.edu.al/pdf/Guida_e_Studentit_2016-2017.pdf)



<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	Programet e studimit BSc në Drejtësi në Kolegjin Universitar Wisdom, duke qenë të përgjithshme për formimin e një juristi, mund të thuhet pa hezitim që plotësojnë nevojat për zhvillimin e një vendi - sa i takon zhvillimit ekonomik, është e vështirë të realizohet një analizë e tillë, pasi siç u përmend edhe më sipër mungojnë të dhënat për kërkjesat e tregut të punës, për zhvillimin ekonomik të vendit tonë.
--	--

#### Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; <b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme; <b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. Në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;	Programet e studimit BSc në Drejtësi rezultojnë që përshtaten plotësisht me Strategjinë për zhvillimin e institucionit, me misionin dhe vizionin e tij. Programet e studimit BSc në Drejtësi, nga sa u përmend edhe më sipër janë kurrikula që ofrojnë në një shkallë të lartë njohuri të përgjithshme lidhur me tre fushat kryesore të së drejtës (publike, civile dhe penale). Nëse i referohemi programit të studimit, lëndët me zgjedhje ofrojnë edhe njohuri lidhur me shkrimin akademik, logjikën juridike, informatikën juridike; një element i vlefshëm në kurrikulat e këtij programi është ofrimi që në vitin e parë të lëndëve me profil psikologjik/sociologjik në raport me të drejtën, duke ofruar edhe një dimension ndërdisiplinar të programit.
--	--

#### II - ORGANIZIMI, DREJTAMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMeve TË STUDIMEVE Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar; <b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: a. mundësitet e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; b. kërkjesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të registrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programë të ngjashme në institucionet simotra.	Programet e studimit BSc në Drejtësi ofrojnë një formim të përgjithshëm të studentit në module që reflektojnë kryesisht ndarjet e së drejtës në fushën publike, civile dhe atë penale - kjo u mundëson studentëve përshtatjen lehtësisht në programe të mëtejshme të avancuara studimi të ciklit të dytë e më tej, si në Shqipëri edhe jashtë. Formimi i përgjithshëm në këtë program krijon lehtësi përshtatje edhe në tregun e punës, megjithatë në Shqipëri mungojnë të dhënat e sakta e të plota në nivel institucionesh shtetërore për kërkjesat e tregut të punës, dhe konsiduar edhe faktin që shumica e studentëve që mbarojnë studimet BSc vazhdojnë edhe më tej programe të ciklit të dytë, arrijmë natyrshëm në përfundimin që është e vështirë të realizosh në terrenin shqiptar një analizë të saktë e të plotë të nivelit të suksesit të kurrikulave të një programi që ofrohet. Sic u informuan edhe nga stafi i Kolegit, dhe sic reflektohet edhe nga aktivitetet e shfaqura në faqen e internetit, institucioni në mënyrë periodike realizon takime me ekspertë të ndryshëm të cilët paraqesin eksperiencat e tyre lidhur me sfidat e tregut të punës, organizon dy aktivitete të dedikuara çështjeve të punësimit 'Ditët e punësimit' dhe 'Ditët e Karrierës', ku të
--	--



	cilat ftohen përfaqësues të Kompanive të ndryshme apo ekspertë që nëpërmjet diskutimeve, asistencës dhe konsultimeve, janë një mbështetje shumë e madhe për programet e studimit të ofruara në drejtim të ruajtjes së lidhjeve dhe tendencave nga tregu i punës.
<b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;	Programet e studimit BSc në Drejtësi, nuk u vu re në asnjë rast që të binin ndesh me interesat kombëtarë - <i>a contrario</i> , nga pedagogët e këtij kolegji, u vu re një interes i jashtëzakonshëm për të studuar në thellësi, çështje që lidhen me vlerat, historinë dhe trashëgiminë e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri. Në këtë kuadër vlen të përmendet monografia në proces botimi e pedagog Dr. Elma Sherifi me titull ' <b>Trashëgimia Institucionale e Shqipërisë prej antikitetit deri në vitin 1920</b> ', një studim i bazuar mirëfilli mbi dokumenta dhe hulumtime të kryera për herë të parë, një punim që u vlen jo vetëm studentëve të Kolegit, por edhe të gjithë juristëve, historianëve dhe çdo qytetari që ka interes të njohë zhvillimin e kombit tonë.
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	
<p><b>Konkluzione të GVJ:</b>  Në përfundim, vlerësohet se Programi i studimit BSc në Drejtësi është hartuar në përputhje me kërkosat dhe standarde Ligin 'Për Arsimin e Lartë', në përputhje më kërkosat e Kartës së Bolonjës për formim të përgjithshëm në studimet e ciklit të parë, reflekton plotësisht formimin teorik të studentit por edhe atë praktik nëpërmjet lëndës së praktikës profesionale dhe lëndëve me zgjedhje. Programet mësimore, stafi akademik por edhe aktivitetet e organizuara nga Koleksi reflektojnë tendencën për të ecur njëkohshëm me zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe me zhvillimet e rajonit e më gjerë. Ato gjithashtu reflektojnë kultivimin, nxitjen dhe transmetimin e vlerat kombëtare, jo vetëm gjatë procesit të mësimdhënies/nxënies por edhe nëpërmjet botimeve.</p> <p><b>Në këtë këndvështrim standardet plotësohen tërësisht.</b>  <b>Sugjerim</b> - Aktivitetet dhe botimet që janë zhvilluar nga studentët dhe pedagogët e Programit BSc në Drejtësi që refletojnë edhe vlera kombëtare, mund të gjejnë pasqyrim më të plotë në faqen e internetit të Kolegit.</p>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Termi reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënavë të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënieve së informacionit

Bazuar në raportin e vetëvlerësimit të paraqitur nga Koleksi Universitar Wisdom, nga verifikimi në vetë institucionin si edhe intervistat me drejtuesit e këtij institucionit, rezulton se Koleksi Universitar Wisdom është i organizuar në dy Fakultete, në atë të Drejtësisë dhe në atë të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.

Fakulteti i Drejtësisë, përbehet nga tre njësi bazë dhe më konkretisht nga Departamenti i së Drejtës Publike, nga Departamenti i së Drejtës Private dhe nga Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrdhënieve me Jashtë.



Sipas RVB rezulton se struktura e Fakultetit ruan ende organizimin sipas legjislacionit të vjetër të arsimit të lartë kështu përveç njësive bazë të siparcituara, rezulton se ende është funksional Këshilli i Fakultetit. Nga intervista me Dekanin e Fakultetit, u konkludua se kishte pasur një riorganizim në kuadër të legjislacionit të ri për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, duke u hartuar edhe Statuti i ri i cili ishte miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit.

Përsa i përket dokumentacionit, në lidhje me këtë pjesë, rezulton se ishte vënë që në fillim në dispozicion nga ana e Kolegit Universitar Wisdom dhe është ngarkuar edhe në platformën elektronike ASCAL. Në ambientet e Kolegit na u vu në dispozicion Statuti i ri i këtij institucioni, por nuk është ngarkuar në platformën elektronike ASCAL.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

**3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Përsa i përket strukturës didaktike, sic e përmendem më sipër Fakulteti i Drejtësisë ndahet në tre njësi bazë, në Departamentin e së Drejtës Publike, në Departamentin e së Drejtës Private dhe në Njësinë e Kërkimit Shkencor dhe Marrdhënieve me Jashtë. Këto struktura nuk rezulton që të janë organizuar në nëndarje të tjera. Gjatë vizitës në institucion na u komunikua që Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Private dhe Njësia e kërkimit shkencor në bashkëpunim me njëra tjetrën. Koordinatori i këtij programi është Prof. As Kosta Gazeli, Përgjegjës i Departamentit të të Drejtës Publike.

Përsa i përket numrit të personalit akademik efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK) të dhënat e vetëdeklaruara dhe ato të verifikuara në institution rezulton se janë të njëjta dhe nuk ka ndryshime.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat Aneksi 1/2, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)
- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Plotëso Tabelën, Aneksi 3)
- Të dhënat sipas seksit
- Të dhëna sipas moshës së personelit
- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat
- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Fakulteti i Drejtësisë ka një staf akademik prej 23 vetash të cilat ndahen si më poshtë:  
Departamenti i së drejtës Private, 7 anëtarë, nga të cilët 4 janë me tituj/grada (1 Profesor Doktor, 2 Doktorë, 1 Docentë). Të gjithë janë anëtarë akademik efektivë.

Departamenti i së Drejtës Publike, 9 anëtarë, nga të cilët 7 janë anëtarë akademikë efektivë dhe 2 janë anëtarë akademikë me kontratë. Nga PAE, 3 janë anëtarë me tituj shkencorë (profesorë të asocuar). Përsa i përket 2 anëtarëve PAK ato janë 1 me titull Profesor, 1 me titullin Profesor i Asociuar.

Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrdhënieve me Jashtë përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 4 janë me gradën shkencore “Doktor”.

Në total në Fakultetin e Drejtësisë janë 13 anëtarë janë të kategorisë “lektor” dhe 10 janë të kategorisë asistent-lektor.

Përsa i përket raportit midis gjinive rezulton se anëtarë PAE janë 9 anëtarë meshkuj dhe 11 anëtarë femra. Ndërsa nga anëtarët PAK, janë 2 meshkuj.

Në lidhje me moshën e stafit akademik me kohë të plotë, rezultojnë të dhënat e paraqitur tek Aneksi 5 i këtij rapporti

Përsa i përket stafit akademik me kontratë rezulton se një anëtar që mban titullin Profesor i Asociuar përfshihet në grupmoshën 66-68 vjeç ndërsa anëtarë tjetër që mban titullin Profesor, përfshihet në grupmoshën mbi 68 vjec.

Nga verifikimi dhe konstatimet në institucion rezulton se të gjithë anëtarët kanë kontrata të rregullta dhe të plota si edhe njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Në lidhje me cilësinë e stafit ndihmës/administrativ, rezulton se Kolegji Universitar Wisdom ka staf administrativ të mjaftueshëm i cili mbështet nëpërmjet veprimtarisë teknike, administrative dhe materiale, stafin akademik, si edhe mirëfunksionimin e shërbimeve të tjera në këtë institucion.

Përsa i përket dokumentacionit, përvèc atij të vënë që në fillim në dispozicion dhe të ngarkuar në platformën elektronike ASCAL për këtë pjesë nga ana jonë u kërkuan dhe u vunë në dispozicion edhe këto dokumenta:

1. *Formular vleresimi i performances akademike*
2. *Kalendari i Kotrollit te Cilesise NJSBC*
3. *Model Formati i Kerkimit Shkencor per stafin akademik*





4. Procedura per aktivitete shkencore te realizuara.pdf
5. Plan vjetor i punes se NJKSHMJ
6. Procedurat per praktikat profesionale
7. Pyetsor Studenti dhe pyetsor pedagogu, pyetsor i plotesuar si model
8. Raport semestral pedagogu, model
9. Relacion per realizimin e programeve te lendeve NJSBC
10. Raport permblehdhes i relacioneve
11. Raporti mbi kontrollin

Dokumentacioni i kërkuar rezultoi i plotë dhe në përputhje me standardet ligjore dhe përshkrimet në RVB.

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standaret/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë; <b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit; <b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.	<p>Rekrutimi i personelit është kryer në përputhje me legjislatin që ka qenë në fuqi për arsimin e lartë dhe Kodin e Punës. Po kështu rezulton se janë respektuar kërkesat e statutit, nen 47 dhe me nenin 21 të Rregullores së Kolegjit. Shpallja për vendet vakante është bërë publike në faqen e internetit të Kolegjit. Procesi kalon në një procedurë vlerësimi paraprak dhe më pas intervestimi nga Komisioni ad hoc që ngrihet për këtë qëllim.</p> <p>Nga RVB dhe nga verifikimi në institucion rezulton që personeli akademik më kohë të plotë përbën më shumë se 70% të personelit të angazhuar. Më konkretisht personel akademik i jashtëm janë vetëm dy anëtarë.</p> <p>Në Fakultetin e Drejtësisë, ndiqet në procedurë vlerësimi e personelit akademik i cili përshtin të dhënat që vijnë nga pyetësori i studentëve, pjesëmarrje nëpër auditore gjatë mësimdhënies, respektimin e orarit mësimor (mbi baza kontrolli të rastësishëm). Të gjitha këto të dhëna bëhen pjesë e një analize vjetore në çdo departament. Monitorimi realizohet nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Institucioni mban një bazë të dhënavë të raporteve të rekrutimit të personelit, si edhe të njoftimeve për punë.</p>
<b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;	Nga kontrolli në njësinë e burimeve njerëzore, rezultoi se të gjithë anëtarët e personelit akademik kishin dosjen e tyre personale në të cilën gjendeshin Dokumenti i identitetit, Dokumenti që vërteton punën e kryer me pare, Libreza e kontributave të sigurimeve shoqërore, Diploma Universitare dhe lista e notave, Diploma dhe dokumente të tjera te gradave dhe titujve shkencore, si dhe të kualifikimeve të tjera,
<b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;	



<b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;	Libreza shëndetësore, Adresa e vendbanimit, Lista e botimeve, artikujve dhe kërkimeve shkencore.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor," ose titullin akademik "Docent".	Nga RVB si edhe nga verifikimi në institucion rezulton se Fakulteti dhe njësitë bazë dispozojnë listën e plotë të personelit akademik. Nga verifikimi i praktikave të punësimit në Kolegjin Universitar Wisdom, rezulton ky institucion i publikon kriteret e punësimit të personelit akademik. Nga verifikimi në institucion, rezulton se titullarë të lëndëve që aktivizohen nga Institucioni janë anëtarë të personelit akademik me titull Profesor, Profesor i Asociuar, Doktor, si edhe Docent. Gjithashtu një pjesë e pedagogëve janë në proces të kualifikimit shkencor (doktoraturë).

#### Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përbushjen e misionit të tij.

<b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollorë; <b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë; <b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).	Studentëve u vihen në dispozicion kompjutera portabël në ambjentet e Bibliotekës, si edhe mësimdhënia mundësohet nëpërmjet projeksioneve, videoprojektorëve dhe materialeve në powerpoint. Po kështu në ambjentet e Kolegit Universitar ka paisje të ndryshme si printerë, skanera, lexues DVD et., të cilat mbështesin procesin e mësimdhënieς. Nga ana e Institutonit rezulton se ka një personel të mjaftueshëm akademik dhe ndihmës akademik i cili mundëson zhvillin normal të procesit të mësimdhënieς si edhe realizimin e shërbimeve në favor të studentëve Përsa i përket praktikës mësimore nga ana e Kolegit Univeristar Wisdom është vënë personel i mjaftueshëm duke u ruajtur raporti 1 pedagog/12 studentë.
---	--

#### Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor; <b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.	Në lidhje me këtë kriter rezulton se për kualifikimin e mëtejshëm të vetë stafit akademik nga ana e Kolegit universitar janë ndjekur këto politika: a) ulje e ngarkesës mësimore ndaj disa pedagogëve me qëllim krijimin e mundësisë për rritje profesionale dhe zhvillimin e kërkimit shkencor, b) organizimin e konferencave shkencore, kombëtare dhe ndërkontinentale, c) publikimin e artikujve në revistën shkencore të Kolegit, ç) në disa raste, mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrje në aktivitete me karakter shkencor jashtë vendit, d) publikimi i botimeve shkencore të stafit akademik ka vetë Kolegji universitar me fondet e tij. Nga RVB si edhe nga verifikimi në institucion rezultoi se pranë tij ndodhesh një baze e plotë e
---	--

të dhënave të programeve të studimit të ofruara.  
Ato gjenden pranë departamenteve

#### **Konkluzione të GVJ:**

Kolegji Universitar Wisdom ndjek procedura të rregullta dhe transparente të punësimit të personelit. Midis anëtarëve të stafit akademik, ka pedagogë të kualifikuar dhe me përvojë të cilët kanë edhe tituj dhe grada shkencore. Këto pedagogë janë edhe titullarë të lëndëve. Ndërkoq që ka edhe pedagogë të tjerë, të rinj të cilët janë në proces kualifikimi.

Kolegji zbaton mekanizma kontrolli që monitorohen dhe përpunohen nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe diskutohen periodikisht me autoritetet drejtuese. Kolegji diaponon të dhëna të plota për aktivitetin e të gjithë pedagogëve dhe procesit të mësimdhënies. Kolegji disponon të dhëna të plota për programet e studimit që ofron; ato u vihen në dispozicion studentëve në çdo kohë.

#### **Standardet plotësohen tërësisht.**

**Sugjerime** – Duke qenë se Kolegji Universitar Wisdom investon në forma të ndryshme në rritjen e kualifikimit shkencor dhe profesional të stafit akademik, sugjerohet që në kontratën e punës individuale të parashikohet një klauzolë që anëtarë i personelit akademik do të qendrojë mbas marrjes së gradës/titullit shkencor edhe për një periudhë kohore të caktuar pranë këtij institucioni arsimor.

Programet e studimit duhet të vendosen në faqen e internetit të Kolegji Universitar në mënyrë që, si studentët ashtu edhe persona të tjerë të interesuar të kenë akses në to.

#### **4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjite e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Nga analiza e RVB si edhe nga verifikimi në institucion rezulton se të dhënat e raportuara janë të sakta. Përkatësisht Kolegji Universitar Wisdom ka përshtatur ambjente të reja duke krijuar një kampus universitar i cili siguron kushtet e nevojshme për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. pra, mbulon nevojat e këtij institucioni arsimor.

Nga pikëpamja materiale në Fakultetin e Drejtësisë, ambjentet janë të paisura me printerë, fotokopje, skanera, kamera, videokamera, DVD, televizione, video projektorë etj. Për një detajim të këtyre paisjeve, referojuni Ankesit 6 të këtij rapporti.

Përsa i përket ambjenteve të për zhvillimin e programit mësimor rezulton se Fakulteti i Drejtësisë i Kolegji Universitar Wisdom ka të përshtatur ambjente të bollshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e mësimit, si auditorë për leksione dhe seminare, ambjente për aktivitete promovuese, ambjente për bibliotekën, qeverinë studentore etj. Për të dhena më të plota për këto ambjente, referojuni aneksit 7 të këtij rapporti.

Kolegji Universitar Wisdom ka krijuar gjithashtu dhe mirëmban ambjente të mjaftueshme edhe për stafin akademik, si zyra për drejtuesit e Fakultetit të Drejtësisë dhe përgjegjësave të Departamentit, për vetë departamentet, njësinë kërkimore-shkencore, njësinë e sigurimit të cilësisë, financës etj. Për të dhena më të plota për këto ambjente, referojuni aneksit 8 të këtij rapporti.



### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminarë
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore / profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin / kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet / qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standarde/ kriteret	Përbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Nga RVB si edhe nga verifikimi në institucion rezulton se në dispozicion të studentëve ekziston e gjithë literatura bazë dhe materiale let ndihmëse për cdo lëndë. Më konkretisht cdo tekst mësimor apo material tjeter i përmendur në programet e studimit ndodhet i aksesueshëm për studentët. Nga verifikimi në institucion rezulton se në bibliotekën e institucionit ekziston e gjithë literatura e nevojshme për realizimin e programit të studimit nga ana e studentëve.</p> <p>Në bibliotekën e fakultetit ekziston libraria elektronike ProQuest e cila mundëson aksesin në mbi 10.000 tituj librash në gjuhë të huaj. Aksesi mundësohet nëpërmjet regjistrimit të postës elektronike personale si edhe një fjalëkalimi që jepej nga ana e punonjësve të bibliotekës. Nga intervistat me studentet rezultoi se kjo librari elektronike përdorej prej tyre në realizimin e detyrimeve mësimore.</p> <p>Shtimi i zërave në bibliotekë bëhet mbi bazën e kërkesave të vetë stafit akademik, në fillim të cdo viti akademik. Sipas të dhënave të administruara rezulton se për vitin akademik 2015-2016, si libra të rinj rezulton se janë blerë 32 tituj, ndërsa për vitin akademik 2016-2017, si libra të rinj rezulton se janë blerë 15 tituj. U konstatua se oraret e bibliotekës janë gjithmonë të shpallura dhe janë në përshtatje</p>



	me oraret e programit të studimit. Biblioteka funksionon gjatë orarit 9.00-19.30.
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mqedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mqedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mqediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përbajnjë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laboratori.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mqediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Nga të dhenat e paraqitura në RVB si edhe nga verifikimi në institucion rezulton se në të ka ambjente të mjaftueshme për realizimin e procesit të mësimdhënieς, të aktiviteteve akademike, si edhe ambjente për administratën dhe personelin akademik. Megjithatë u konstatua se njësia e burimeve njerëzore ndante të njejtin ambjent me bibliotekën e institucionit. Nga verifikimi në institucion rezultoi se të gjitha auditoret por edhe ambjentet e tjera ishin të sistemuara dhe me hapësirë të bollshme. Ato ishin të paisura më të gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe materialet didaktike përkatëse. Në të gjitha auditoret kishte paisje për projektimin e leksioneve dhe materialeve të tjera në funksion të mësimdhënieς. Po kështu në Bibliotekën e Fakultetit, për studentet sigurohej mundësia e përdorimit të kompjuterave portable, gjithsej 12 copë. Për shkak te vëtë natyrës së studimeve në fushën e drejtësisë, në këtë rast nuk është e nevojshme prania e një laboratori. Në bibliotekën e fakultetit, studentëve u krijohet mundësia që nëpërmjet kompjuterave protabël të kënë akses në librarinë elektronike ProQuest si edhe në internet. Kapacitetet infrastrukturore të verifikuara në institucion garantojnë realizimin e praktikave mësimore. Megjithatë do të ishte e këshillueshme përshtatja e ndonjë ambjenti si sallë gjyqi, me qëllim krijimin e perceptimit për studentët e zhvillimit të debateve dhe detyrave të tyre në një ambjent të tillë.</p>

#### **Konkluzione të GVJ:**

Në institucion ndodhet e gjithë literatura e nevojshme bazë për zhvillimin e procesit të mësimdhënieς për të gjitha lëndët dhe Biblioteka e Kolegit ofron edhe literaturë ndihmëse në mbështetje të programeve të studimit; ajo është pasuruar rregullisht me libra të rinj dhe ka akses të librarisë online nga stafi akademik dhe studentet (*ProQuest me mbi 10.000 tituj*). Kolegji universitar ka hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve dhe stafin akademik dhe administrativ.

#### **Standardet plotësohen tërësisht.**

**Sugjerim** - Njësia e burimeve njerëzore e cila ndodhet në ambjentet e bibliotekës duhet të vendoset në ambjente të tjera të përshtatura vetëm për të. Po kështu një nga auditorët mund të përshtatet në formë e një sallë gjyqi për realizimin e gjyqeve imituese dhe aktiviteteve të tjera akademike.

#### **5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** burimet e financimit, kostojat për student, kapacitetet menaxhuese.

Kolegji Universitar Wisdom mbështetet kryesisht në të ardhurat e krijuara nga pagesat e studentëve. Veprimtaria e tij ekonomike, siç u informuan gjatë vizitës në



institucion reflektohet në bilancet financiare të cilat përgatiten dhe depozitohen sipas kërkesave ligjore tatinore. Institucioni realizon periodikisht auditim të brendshëm të fondeve dhe shpenzimeve të kryera, të cilat mundësojnë analizimin e plotë të situatës ekonomiko-financiare dhe shpërndarjen/alokimin e fondeve në mënyrë eficiente. Lidhur me Koston për Student, Kolegji është në proces vlerësimi/analizimi të vazhdueshëm, megjithatë sic rezulton edhe nga Tabela e Bilancit midis të ardhurave dhe shpenzimeve në vitin 2014 dhe vitin 2016 shpenzimet kanë rezultuar më të mëdha në raport me të ardhurat, duke u fokusuar në shpenzime për përmirësimin e infrastrukturës së Kolegjit. Lidhur me vitin 2016, mund të thuhet se është i vetmi vit që institucioni ka realizuar fitim. Në këtë këndvështrim, konkludohet se mesatarisht, kosto për student i kalon pagesën/tarifën që studenti paguan për shkollimin e tij.


Lidhur me kapacitetet menaxhuese, burimet njerëzore për këtë veprimitari janë bazuar të Kancelari i Kolegjit si dhe tek Zyra e Financës. Për një shpenzim sa më eficient të fondeve për programin BSc në Drejtësi, u informuam se ka komunikime, takime dhe diskutime të vazhdueshme midis Dekanit, Rektorit dhe Kancelarit për të koordinuar interesat/kërkesat e programit me mundësitë financiare. Më pas, ekzekutimi i kësaj vendimarrjeje realizohet nga Zyra e Financës, e cila procedon me përgatitjen e të gjithë dokumentacionit financiar.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):
  - Grantet për kërkim
  - Konsulencat, shërbimet
  - Tarifat për dhe gjatë shkollimit
  - Sponsorizimet
  - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
  - Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
  - Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)
- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)
- Dokumentacioni përkates i marrë në vizitat në institucion

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standarde/krriteria	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij; <b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj; <b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituarave dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Institucioni/Kolegji realizon auditim të përvitshëm të situatës së tij financiare, në varësi të të ardhurave që vijnë kryesisht nga tarifat e studimit. Ky është një detyrim financiar që kërkohet edhe nga legjislacioni tatimor në fuqi, ndaj auditimi i brendshëm dhe i jashtëm është një proces që realizohet cdo vit.</p> <p>Raportet financiare përbajnë të gjitha elementët/zërat financiarë lidhur me të ardhurat dhe me shpenzimet.</p> <p>Raporti nuk përban informacion financiar lidhur me Grantet apo të ardhura të tjera që mund të jenë përfituar nga kontratat e shërbimeve. Nga intervista në institucion rezulton se përfitime të tilla, nuk ka pasur.</p>



## VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR

**Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Kolegji Universitar Wisdom harton reportin financiar që përmban një pasqyrë të detajuar financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare; Këto informacione janë të reflektuara për të gjitha vitet e tjera.</p> <p>Lidhur me <u>qëndrueshmërinë financiare</u> të institucionit, vihet re që përgjatë viteve të zbatimit të programit BSc në Drejtësi, por edhe gjatë periudhave të mëparshme, pagesat janë kryer në kohë, pa vonesa dhe përvèc burimeve financiare nga tarifat e studentëve, Kolegji ka investuar në infrastrukturë, që lidhet edhe me kryerjen e shpenzimeve operacionale. Zhvendosja dhe Investimi në një godinë të re, të mirë-organizuar dhe të përshtatur për nevojat e Kolegjit krijojnë gjithashtu premisa për një zhvillim të qëndrueshëm edhe financiar të institucionit.</p> <p>Kjo vihet re edhe në faktin që gjatë viteve 2015-2017, shpenzimet i tejkalojnë ndjeshëm të ardhurat e programit, gjë që synohet të përmirësohet në vitet në vijim - kjo është edhe arsyja pse institucioni po investon për të krijuar asete të qëndrueshme materiale dhe njerëzore, me qëllim që të krijojë terrenin e përshtatshëm për të përthithur më shumë studentë vitet e ardhshme në programin Bachelor në Drejtësi, si dhe në programe të tjera.</p>
---	---

### **Konkluzione të GVJ:**

Kolegji Universitar Wisdom mbështetet kryesisht në të ardhurat e krijuara nga pagesat e studentëve. Veprimtaria e tij ekonomike reflektohet në bilancet financiare të hartuara kërkesave ligjore tatimore. Institucioni realizon periodikisht auditim të brendshëm të fondeve dhe shpenzimeve të kryera, të cilat mundësojnë analizimin e plotë të situatës ekonomiko-financiare dhe shpërndarjen/alokimin e fondeve në mënyrë eficiente.

Kosto për Student tejkalon tarifën e shkollimit pasi shpenzimet tejkalojnë të ardhurat. Institucioni/Kolegji ka burime njerëzore të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe ka një koordinim mjaft të mirë të punës për një shpenzim sa më eficient të fondeve për programin BSc në Drejtësi.

Institucioni ka reflektoar qëndrueshmërinë financiare, ka investuar në infrastrukturë dhe ka kryer investime për të krijuar asete të qëndrueshme materiale dhe njerëzore për të përthithur më shumë studentë vitet e ardhshme.

**Institucioni i plotëson tërësisht standardet lidhur me çështjet e financimit, raportimit financiar, auditimit dhe ofron qëndrueshmëri financiare dhe institucionale.**

## **6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

### **Pjesa përshtkrimore**

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritura e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.



Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në ditët e sotme është një sfide e vazhdueshme, që përfshin jo vetëm angazhimin e stafit akademik dhe administrativ të Kolegit por edhe pjesëmarrjen efektive të studentëve. Për këtë qëllim, Kolegji Universitar Wisdom ka ngritur një strukturë të posacme, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë/NjSBC si dhe ka miratuar një Rregullore për funksionimin e saj, ku parashikohen kriteret e sigurimit të cilësisë, funksionet e grupeve të sigurimit të cilësisë, si dhe procedurat e vlerësimit të brendshëm.

Vlerësimi i brendshëm i Cilësisë është një proces që kryhet nga institucioni, për të gjykuar për përbushjen e standardeve të cilësisë dhe përfshin mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve dhe të diplomuarve, intervistimin e pedagogëve dhe të studentëve, dhe vlerëson statusin e institucionit ose/dhe të programit të studimit përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë – ky proces përfundon me hartimin e një Raporti/Relacioni që i përcillet autoriteve drejtuese të tij (Rektor, Zv/Rektor, Dekan, Përgjegjës Departamenti, etj.) si dhe diskutohet në një mbledhje të posacme për të adresuar problematikat dhe për të ofruar zgjidhje e përmirësuar situatën. Gjithë informacioni lidhur me procesin e vlerësimit të cilësisë na u vu në dispozicion gjatë vizitës në institucion.

Ajo që vihet re për programin e BSc në Drejtësi, për vitin akademik 2016-2017 është hartuar edhe Plani Strategjik i përmirësimit të cilësisë së Kolegit. Të njëjtët plane janë hartuar nga institucioni edhe për vitet e mëparshme akademike. Synimi kryesor i tyre ka qënë rritja e cilësisë së mësimdhënies, përgatitja e vazhdueshme profesionale e stafit, aftësimi i studentëve në njohuritë e përgjithshmë për çështjet ligjore si dhe përgatitja e tyre për tregun e punës, apo edhe për vijimin e studimeve të thelluara në nivel Master, apo edhe në programe të tjera studimi dhe formimi profesional.

Lidhur me sigurimin e cilësisë në institucion, është krijuar Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila vepron si një strukturë e pavarur, për të ofruar vlerësim objektiv dhe këshillim, me qëllim përmirësimin e veprimit tarisë mësimdhënëse dhe asaj mësimnxënëse, kërkimit shkencor, aktiviteteve ndihmëse profesionale, etj. Mekanizmat që institucioni (*nëpërmjet NjSBC*) për të vlerësuar punën janë parashikuar në "Rregulloren e Njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë" të miratuar nga Senati i institucionit, në Tetor të vitit 2015; ato janë kryesish forma vlerësimi dhe kontrolli periodik me qëllim njohjen e situatës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Instrumentat e parashikuar nga Rregullorja dhe të përdorur përgjatë programit BSc në Drejtësi janë si më poshtë:

I. Hartimi dhe plotësimi i Pjetësorit për Pedagogët – Pjetësori hartoher nga NjSBC dhe plotësohet në mënyrë anonime nga vetë pedagogët, me qëllim që të shprehen lidhur me procesin e mësimdhënies në të gjithë komponentët e saj, për programin e studimit BSc në Drejtësi.

II. Hartimi dhe plotësimi i Pjetësorit për Studentët – Pjetësori hartoher nga NjSBC dhe plotësohet në mënyrë anonime nga studentët; ai plotësohet në përfundim të çdo semestri, pra 2 herë në vit dhe pëmban jo vetë pyetje për pedagogët, por edhe për çështje të tjera, që lidhen me leksionet, komunikimin student-pedagog, infrastrukturën mësimore, për të marrë mendime për aspektet kryesore të zhvillimit të performancës dhe cilësisë, etj.

III. Kalendarët semestralë të Kontrollit të Cilësisë - Për të planifikuar punën lidhur me kontrollin e cilësisë, gjatë vizitës në institucion u informuam se në Tetor 2016, NjSBC ha hartuar kalendarin e kontrollit të brendshëm të cilësisë për programet mësimore për vitin akademik 2016-2017. Sipas këtij kalendarit, në bashkëpunim edhe me departamentet janë vizituar seminaret dhe leksionet, duke hartuar relacionet përkatëse. Ky është një risi e cila ka ndikuar në rritjen e përgjegjshmërisë akademike, të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe krijimin e praktikave të leksioneve apo seminarëve të hapura, që mund të ndiqen nga kushdo në çdo kohë që ka interes.

IV. Në përfundim të kontrolleve për të gjitha lëndët e semestrit, u informuam se është organizuar një takim i përbashkët I pedagogëve të Fakulteteve dhe Departamenteve, me përfaqësues nga NjSBC dhe studentë, ku janë ballafaquar me mendimet dhe opinionet e gjithësecilit në lidhje me problematika dhe sugjerime të mundshme. Ky takim reflekton një qasje të re duke afuar dhe duke vendosur ura komunikimi më të fortë ndërmjet studentëve dhe stafit akademik.

**V. Raporti semestral për çdo pedagog** - Nga vizita në institucion u informuam se në përfundim të semestrin, çdo pedagog përgatit Relacionin për realizimin e programeve të lëndëve ku pasqyrohet përbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës (syllabusit), pjesëmarrja, kalueshmëria, nota mesatare, mendime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit mësimor për të ardhmen, si dhe çështje të tjera që lidhen me përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, që gjykohen të rëndësishme nga ata, gjatë procesit mësimor semestral. Kjo teknikë sjell një rritje të cilësisë në mënyrën e vlerësimit individual të secilit pedagog për lëndën/modulin që zhvillon, duke identifikuar synimet/objektivat në raport me realizimin e tyre, në artikulimin e sfidave të reja, të përmirësimit të syllabuseve dhe literaturës, të teknikave të mësimdhënies/mësimnxënies, të komunikimit, të etikës, të vlerësimit, si dhe analizimin e çdo çështjeje tjetër të rëndësishme.

**VI. Intervistat me studentët** - Intervistat apo takimet jo formale me studentët, zhvillohen me qëllim që të diskutohet për procesin mësimor në përgjithsi dhe për probleme të veçanta që ata hasin përgjatë procesit mësimor. Në takim nuk janë të pranishëm pedagogët pasi ata duhet të ndihen të lirshëm për të shprehur të gjitha problematikat e tyre dhe për të diskutuar lidhur me alternativat për të përmirësuar përfshirjen e tyre dhe cilësinë e mësimdhënies apo të aktiviteteve të tjera.

**VII. Vëzhgimi/Monitorimi i performancës së studentëve** - një mekanizëm monitorues që në vetvete përbën edhe një gjetje apo tregues të cilësisë, bazuar mbi:

- Vijueshmërinë e studentëve në leksione, pjesëmarrjen dhe angazhimin në zhvillimin e debatit dhe të shkëmbimit të opinioneve në grupe gjatë orëve të seminarit;
- Nivelin cilësor të angazhimit të tyre në procesin e debatit dhe shkëmbimit praktik të opinioneve gjatë zhvillimit të orëve të seminareve, përmes ballafaqimit të kazuseve të sjella nga praktika gjyqësore;
- Detyrave të kursit - gjatë procesit mësimor, pedagogu paraqet disa probleme ligjore apo çështje që kërkojnë përfshirjen e studentit në zgjidhjen e tyre konkrete; studentët mund të punojnë në grupe apo edhe individualisht, mund të bëjnë kërkim ligjor dhe shkencor, mund të analizojnë rastin dhe problematikën si dhe mund të marrin rolin e palëve/të avokatit/gjyqtarit/prokurorit në një proces të simular;
- Kolokiumin, testim paraprak dhe i pjesshëm për njojuritë e studentit, që në varësi të modulit mund të organizohet me shkrim apo edhe me gojë - një proces i tillë aftëson studentin për t'u angazhuar periodikisht për njojuritë e fituara dhe për të koordinuar njojuritë fillestare/të përgjithshme me ato të avacuara/specifike;
- Testimi përfundimtar, që realizohet me anën e provimit të përgjithshëm apo të punimit për mbrojtjen e diplomës

- Praktikave profesionale, që realizohet në një modul të plotë në përfundim të studimeve të nivelit BSc. Praktika mësimore aftëson studentët në çështje praktike, i oriontua atë për institucionet kryesore të drejtësisë, mënyrën si ato funksionojnë, si hartojnë dokumentat, si marrin vendimet, etj.

**VIII. Shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet pedagogëve dhe ndihma e ndërsjelltë** - gjatë vizitës në institucion u informuam se në mënyrë periodike NjSBC zhvillon takime me pedagogët e programit, ku diskutohet për metodologjinë e mësimdhënies, të kontrollit të njojurive, përmirësimin e tyre, përshtatjen e metodave të reja në gërshetim me teknikat/metodat tradicionale, dhe çdo komponent tjetër në funksion të rritjes së cilësisë dhe shkëmbim të praktikave të mira.

**IX. Veprimtaria kërkimore shkencore e stafit** - është një komponent mjaft i rëndësishëm në funksion të rritjes së cilësisë në procesin e mësim-dhënies/mësim-nxënies. Gjatë vizitës në institucion u informuam se është miratuar një Rregullore e posaçme 'Mbi standarde dhe rregullat punimit në revistën shkencore 'WISDOM', revistë e cila ka numrin e saj të dedikuar të ISSN.

Gjithashtu, për të vlerësuar nga pikëpamja sasiore botimet e stafit akademik të programit, është miratuar Formulari tip mbi raportimin e veprimtarisë për kërkime shkencore të stafit për vitin akademik 2016 -2017. Përpunimi i këtyre të dhënave i jep mundësi NjSBC të ketë informacion të plotë sasior të numrit të botimeve të pedagogëve si dhe angazhimit të tyre në kërkime shkencore, në varësi të fushave të tyre të interesit dhe të zhvillimeve të fundit ligjore.

**X. Aktivitetet Shkencore të Fakultetit të Drejtësisë** - Për vitin akademik 2016-2017, nga Dekani i Fakultetit është miratuar Plani i aktiviteteve shkencore të tij, i cili parashikon zhvillimin e dy konferencave shkencore kombëtare, të realizuara tashmë sipas planifikimit (*përkatesisht Dhjetor 2016 dhe Maj 2917*). Plani gjithashtu përmban detyrimin e shprehur për të gjithë pedagogët e brendshëm të Fakultetit për të botuar të paktën një artikull shkencor në revistën e Kolegit apo edhe në revista të tjera - përgjegjësia e kontrollit të kësaj veprimitaria është realizuar në përfundim të çdo viti akademik nga Përgjegjësit e Departamenteve. Gjithashtu planifikimi parashikon zhvillimin e leksioneve të hapura për studentët e programit BSc në Drejtësi nga pedagogë të huaj, një objektiv që rezulton i përbushur nga Kolegi.

Një element tjetër që vihet re është nxitja në mënyrë të shprehur e pedagogëve për të avancuar në procesin e rritjes akademike, e më konkretisht në marrjen e tituve dhe gradave - një mbështetje e tillë informuam se është realizuar nëpërmjet krijimit të mundësive për të botuar në revistën e Kolegit por edhe në revista të huaja, në organizimin e konferencave kombëtare dhe në reduktimin e ngarkesës në auditor për pedagogët që janë në proces doktorature.

Në përfundim të grumbullimit të informacionit nga të gjithë komponentë e mësipërm, NJSBC harton një Relacion Përbledhës, me të gjitha të dhënat, gjetjet, problematikat dhe sugjerime për përmirësim, i paraqitet autoritetete drejtuese që i diskutojnë në një mbledhje të posaçme, dhe rekomandimet apo planin e punës për përmirësimet e nevojme dhe rritjen e cilësisë ua parashtronjë pedagogëve në fillim të semestrit/vitit akademik të ri.

**Nga vizita në institucion si dhe konsultimi i dokumentacionit të kërkuar lidhur me të dhëna sasiore për vlerësimin e cilësisë, rezultoi përputhshmëri e plotë e të dhënavë të reflektuara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm.**

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
  - Sa anketime kanë bërë me studentët
  - Sa studentë janë anketuar
  - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
  - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
  - Etj
- Kontrolli i brendshëm i cilësisë
- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Plotësoni Tabelën 4, Aneksi 4)
- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; Kolegi përdor kryesisht metodat e vlerësimit sasior dhe cilësor në vlerësimin e ecurisë së programit BSc në Drejtësi - sasior lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të



<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pjetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombe (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>dhënavë nga pedagogët dhe studentët dhe cilësor pasi analizon proceset e mësimdhënies/mësim-nxënies, analizon praktikat e ndjekura në vlerësim, përmirëson komunikimin student-pedagog, etj. Koleksi e ka përfshirë të gjithë këtë informacion në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe kjo reflektohet si në RVB ashtu edhe në procesverbalet e mbledhjeve që stafi akademik dhe ai administrativ, përfshirë edhe studentët kanë realizuar me qëllimin diskutimin e praktikave të vlerësimit të cilësisë dhe reflektimit/pasqyrimit të tyre nga ana sasiore dhe cilësore në Raport. Koleksi ka miratuar jo vetëm strategjinë e rritjes së cilësisë, por për cdo proces që përfshihet vlerësimi i cilësisë dhe rritja e saj ka miratuar aktet përkatëse (siç reflektohet te pjesa pëershkruese <i>supra</i>) - rast evidentues është miratimi paraprakisht i planeve të aktiviteteve shkencore për se cilin nga vitet akademike 2015-2017, të cilat rezultojnë të realizuara sipas parashikimeve. Koleksi për të matur dhe vlerësuar cilësinë, përdor kryesisht metoda dhe teknika të tërthorta të marrjes së informacionit (siç reflektohet te pjesa pëershkruese <i>supra</i>) kryesisht pyetësorë të studentëve dhe pedagogëve, takime ndërmjet tyre, intervista, etj. Këto vlerësimë plotësohen edhe nga marrja e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë kryesisht nga vizitat në leksione dhe seminare, ndjekja e praktikave mësimore, vlerësimet paraprake të pëfjellshme në kolegume, detyrat e kursit, gjyqe të simluara (imituese) etj. Në përfundim të të gjithë këtyre komponentëve të vlerësimit të cilësisë, hartohet një Raport/Relacion i cili i vihet në dispozicion autoriteteteve drejtuese dhe diskutohet në një mbledhje të posaçme.</p>
--	---

#### **VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË**

##### **Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpëra aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për</p>	<p>Nga vizita në institucion, u informuam se Koleksi ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar me kusht në nivel institucional me Urdhër të MAS nr.355 Dt. 25.09.2015. Në dt 18.02.2016 është rekomanduar nga Këshilli i Akreditimit heqja e kushtit për akreditimet e mësipërme. Koleksi përdor të gjitha instrumentet e përshtatshme për sigurimin e cilësisë në</p>
--	--

sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

mësim-dhënie dhe mësim-nxënje, të cilat monitorohen në zbatimin e tyre nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (siç reflektohet te pjesa pëershkruese *supra*) - për krijimin dhe mënyrën e funksionimit të saj institucioni ka miratuar një Rregullore të posacme.

Institucioni i ka kushtuar rëndësi edhe kërkimit shkencor duke krijuar kushte për botime në revistën 'Wisdom' e cila është pajisur me numër ISSN, ka Bordin e saj Shkencor dhe botohet periodikisht. Vihet re që botimet në revistë janë kryesisht të stafit akademik të Fakultetit dhe Kolegit në një larmishmëri tematikash - mund të sugjerohet që për të trajtuar çështje të një rëndësie të madhe apo të aktualitetit, Bordi Shkencor të caktojë herë pas here tema apo problematika ligjore që të mund të trajtohen jo vetëm nga stafi akademik i Fakultetit por kryesisht nga ekspertë të fushës për të rritur cilësinë e debatit juridik.

Kolegi ka një politikë të qartë lidhur me efikasitetin e veprimtarive që kryen dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë të programit BSc në Drejtësi. Ai ndjek procedurën e vlerësimit periodik nëpërmjet pyetësorëve (*për studentët dhe pedagogët*), kontrolleve periorike të paracaktuara ndaj pedagogëve përgjatë leksioneve dhe seminareve, përgjatë praktikës mësimire si dhe nëpërmjet analizës/relacionit individual që çdo pedagog harton në përfundim të modulit që zhvillon (siç reflektohet te pjesa pëershkruese *supra*).

Kolegi përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme (*periodik*) të programit BSc në Drejtësi - kjo realizohet nëpërmjet pyetësorëve, relacioneve, monitorimeve, kontrolleve, intervistave, takimeve, etj, (siç reflektohet te pjesa pëershkruese *supra*)

Kolegi ka qëllim dhe praktikë pune ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programit BSc në Drejtësi lidhur me sigurimin e cilësisë. Kjo proklamohet edhe në Misionin e Kolegit edhe në të gjitha aktet e miratuara për securinë e programit dhe sigurimit të vazhdueshëm të cilësisë. Institucion ka marrë të gjitha masat formale dhe konkrete përmirësimin e cilësisë dhe përmirësimin e saj, por duhet konsideruar edhe cilësia e studentëve që janë pjesë e programit. Duke qenë se studentët jo gjithmonë kanë pasur rezultate të larta në fillim të programit të



studimit BSc në Drejtësi, por edhe përgjatë tij, institucioni ka miratuar edhe bursa në trajtën e ndihmës financiare (*të plota apo të pjesshme në varësi të rezultateve*) me qëllim që të përthithë për sa është e mundur studentë cilësorë por edhe për të nxitur motivimin e studentëve për të arritur rezultate. Ky mekanizëm finanziar reflekton edhe qasjen humane ndaj studentëve dhe familjeve që nuk kanë mundësi për të përballuar kostot e studimeve.

Institucioni / Kolegji ka hartuar edhe një set dokumentacioni informues dhe edukues që në fillim të programit, i cili u shpérndahet studentëve 'Guida e studentit' dhe 'Librat e syllabuseve' të përgatitura nga zyra e kurrikulave.

Për studentët e viti të dytë dhe të tretë, institucioni ka zhvilluar leksione të hapura me pedagogë të huaj për të reflektuar një qasje të re të mësim-dhëniec sic aplikohet në institucionet e huaja, në gjuhë të huaj dhe me literaturë të huaj, ka zhvilluar konferanca shkencore, debate me studentët, ka organizuar studentët në klube studentore në supervizimin e pedagogëve, në fuksion të rritjes së cilësisë dhe nxitjes së aftësive praktike.

Në këtë drejtim, duke qënë se përfshihen kryesisht stafi akademik i Kolegit dhe programit BSc në Drejtësi, do të rekomandohet përfshirja e specialistëve dhe ekspertëve të njohur në aktivitete shkencore apo edhe diskutime praktike të zbatimit të ligjit.

Kolegji ka hartuar Planin Strategjik të zhvillimit të institucionit dhe Planin strategjik të zhvillimit të cilësisë. Ndërkohë që çdo vit akademik hartoherë edhe plani i punës i NjSBC me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Këto akte dhe informacione ende nuk reflektohen në faqen e internetit të Kolegit - nga vizita në institucion u informuam se faqja është në proces rinovimi dhe se së shpejti do të publikohen të dhëna lidhur me aktet e veprimtarisë së Kolegit dhe vlerësimit të cilësisë së tij; megjithatë nga takimi me studentët, pedagogët dhe anëtarët e NjSBC u informuam se kryesisht çështjet e cilësisë së mësim-dhëniec dhe komunikimi me studentët janë objekt diskutimi të vazhdueshëm (*jo-formalishët*) dhe periodik (*formalisht në përfundim të semestrit kur hartoheren raportet apo plotësohen pyetësorët*).

### **Konkluzione të GVJ:**

Vlerësimi i brendshëm i cilësisë kryhet periodikisht nga Institucioni/Kolegji për të vlerësuar përbushjen e standardeve të cilësisë nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë/NjSBC. Institucioni ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për miratimin e akteve formale si Rregullore, Plan Strategjik dhe disponon të dhëna sistematike lidhur me programin. Institucioni përdor mekanizma të ndryshëm duke i ndërthurrur për vlerësimin e cilësisë dhe adresimin e nevojave për përmirësimin e situatës.

**Nga vizita në institucion si dhe konsultimi i dokumentacionit të kërkuar lidhur me të dhëna sasiore për vlerësimin e cilësisë, rezultoi përputhshmëri e plotë e të dhënave të reflektuara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm - standardet përsigurimin e cilësisë në institucion janë plotësuar plotësisht.**

### **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

#### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Termi reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësish në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënieve), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i Studimit BSc në Drejtësi rezultoi të jetë hartuar në përputhje me Ligjin 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 15, datë 04.04.2008 'Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë', Udhëzimin Nr.11, datë 28.02.2011 'Për procedurat dhe dokumentacionin përhapjen e një Institucioni Privat të Arsimit të Lartë, Programeve të reja të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimit jo universitare, të natyrës profesionale dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës' si dhe me Statutin dhe Rregulloren e Institucionit. Plani mësimor realizohet në masën 100% nga stafi i brendshëm. Konkretnisht në këtë program studimi jepin mësim 19 pedagogë me ndarje në titull dhe gradë si: 1 Prof; 3 Prof. As; 7 Dr; 2 Dr në proces; 1 Doc dhe 5 Msc

Programet e lëndëve i janë nënshtruar në vazhdimësi përmirësimit të tyre për çdo semestër nga stafi akademik dhe kanë qëllim përgatitjen e përgjithshme të studentëve, pasi përbajnë lëndë të formimit bazë duke përfshirë module të së drejtës private, publike dhe penale, si dhe lëndë më specifike apo të profilizuara. Programet e lëndëve reflektojn komponentë që lidhen me formimin teorik të studentëve ashtu edhe atë të zbatimit praktik.

**Nga vizita në institucion, inspektimi i dokumentacionit të shkruar dhe miratuar lidhur me programin mësimor, treguesit e matshëm rezultuan të njëjtë me ato të paraqitura në mënyrë të detajuar në RVB sipas tabelave përkatëse.**

Në bazë të Rregullores së programit të studimit të Ciklit të Parë BSc në Drejtësi afati i studimeve për programin e ciliklit të parë është 3 vjet dhe është i organizuar në 6 semestra, me 180 kredite ne total (60 kredite çdo vit akademik). Viti akademik ka 30 javë mësimore në auditor dhe semestri ka 15 javë mësimore në auditor. Ndërkohë që 1 Kredit (ECTS) është i barabartë me 25 orë mësimore punë të studentit (ku 1 orë mësimore



zhevillohet në 60 minuta). Planet mësimore paraqesin ndarjen e ECTS sipas komponentëve dhe formave të mësimdhënies për çdo lëndë/modul. Kurrikula e programit të studimit, kreditet dhe veprimtaritë e tjera formuese janë të organizuara në komponentët e:

- Moduleve të formimit të përgjithshëm
- Moduleve të formimit karakterizues të programit
- Moduleve formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese
- Moduleve formuese të zgjedhura nga studentët ndërmjet atyre që ofron institucionit
- Veprimtari formuese, gjuhë e huaj, praktikë apo stazhe
- Përgatitja e tezës së diplomës - Emërtimi i Diplomës për çdo programi studimi është Bsc në Drejtësi.

Plani mësimor për të gjitha vitet e studimit të programit të ciklit të parë BSc në Drejtësi rezultoi i organizuar dhe i kryes sipas parashikimeve. Plani mësimor ka pësuar ndryshime të herëpashershme, të cilat nuk e kalojnë limitin e përcaktuar nga Ligji (*jo më shumë se 20 % e programit*).

Nga vizita në institucion, inspektimi i dokumentacionit të shkruar dhe miratuar lidhur me ndryshimet e programit mësimor, treguesit e matshëm rezultuan të njëjtë me ato të paraqitura në mënyrë të detajuar në RVB - Tabela 12.

Lidhur me ndryshimet që do të realizohen në kuadrin e programeve të reja të studimit sipas Ligjit 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH', në reflektim edhe të rekomandimit shtatë të lënë nga KA 'ngritjen e një Klinike për punën më studentët' - Klinika Ligjore është krijuar nga Kolegji si organizatë<sup>3</sup>, e cila aktualisht nuk rezulton shumë funksionale. Për ta bërë funksionake dhe të vlefshme për programin e studimit, duke i dhënë edhe funksione praktike mund të shikohet mundësia për të krijuar një modul/lëndë të re 'Klinika Ligjore' e cila fillimisht mund të përshihet si lëndë me zgjedhje e më pas nëse gjykohet e arsyeshme dhe e dobishme mund të kalojë edhe si lëndë e detyrueshme - kjo për të aftësuar studentët për të dhënë asistencë ligjore *pro bono* në raste konkrete si dhe për t'i aftësuar ata për tregun e punës. Një sugjerim praktik lidhet edhe me lëndën/modulin 'Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor' i cili mund të ofrohet si modul i detyrueshëm dhe me më shumë ngarkesë (kredite) me qëllim që të aftësojë studentët në teknikat e arsyetimit ligjor, të shkrimit të mirë ligjor, të hartimit të dokumentave ligjorë, etj. Në këtë kontekst moduli i Shkrimit dhe Arsyetimit Ligjor mund të jetë pjesë integrale edhe e modulit të Klinikës Ligjore, për një rezultat dhe efektivitet maksimal, në rritje të cilësisë dhe nivelit profesional të studenteve.

Gjithashtu u vu re që nuk kishte asnjë modul dedikuar të drejtave të njeriut por ato diskutoheshin si pjesë e çështjeve të së Drejtës Kushtetuese - në ditët e sotme sfidat që paraqet garantimi dhe zbatimi i të drejtave të njëriut janë evidente në të gjithë sektorët dhe institucionet jo vetëm të drejtësisë por edhe më gjerë, përfshirë këtu edhe rolin që ka jurisprudanca (*vendime*) e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ndaj sugerohet që të trajtohet si një lëndë/modul më vete.

Syllabuset e çdo lënde/moduli ishin hartuar të plota dhe përbanin të gjithë elementët e këruar në RVB, përfshirë edhe literaturën bazë (të detyrueshme) dhe atë ndihmëse. Nga shqyrtimi i tabelave të pedagogëve që jepin mësim në ciklin e parë të studimeve BSc në Drejtësi u vu re që disa pedagogë jepnin lëndë/module të cilët nuk janë shumë të lidhur me njëri tjeterin përsa i përket fushës të së drejtës. Ndoshta në të ardhme mund të shikohet mundësia që një pedagog të mund të japë mësim në lëndë/module ku ka fushën e tij/saj të ekspertizës ose edhe lëndë të tjera të ngjashme.

<sup>3</sup> Për më shumë shiko [wisdom.edu.al/klinika-ligjore](http://wisdom.edu.al/klinika-ligjore)



**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standartet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); <b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Kolegji Universitar Wisdom ofron Programin BSc në Drejtësi, akredituar me Urdhër të MAS nr. 188 Dt. 25.04.2011. Kreditet që përsiton një student gjatë një viti akademik me kohë të plotë janë sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), 60 ECTS.
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMeve TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, jepin informacionet e nevojshme për përbajtjen e programeve të studimeve; <b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, jepin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër; <b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, jepin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit; <b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, jepin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.	Departamentet e Fakultetit të Drejtësisë dhe Sekretaria mësimore përgjegjëse për programin e studimi të ciklit të parë BSc në Drejtësi, i jepin studentëve informacionet e nevojshme për përbajtjen e programeve të studimeve. Për këtë qëllim u informuam se është miratuar Guida e Studentit si dhe Libri i Syllabuseve, ky jepen të gjitha të dhënat paraprake për programin. Pëvec kësaj, studentët informohen edhe nga pedagogët përgjegjës për secilën lëndë. Kjo procedurë zhvillohet si për lëndët (modulet) e detyrueshme ashtu edhe për lëndët me zgjedhje. Departamentet, sekretaria mësimore dhe pedagogët u jepin informacion studentëve për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e lëndës apo edhe të programit BSc në përgjithësi. Ato jepin informacion edhe për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo detyrat e kursit, esetë, etj
<b>Konkluzionet e GVJ:</b>	
<p><b>Programi i Studimit BSc në Drejtësi rezultoi të jetë hartuar në përputhje me kriteret dhe standartet ligjore</b> (të parashikuara nga Ligji 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', dhe Udhëzimet përkatëse). Për këtë qëllim Institucioni/Kolegji ka miratuar edhe Statutin dhe Rregulloren e Institucionit.</p> <p>Programet e lëndëve i janë nënshtruar në vazhdimësi përmirësimit të tyre për çdo semestër nga stafi akademik dhe reflektuan komponentë që lidhen me formimin teorik të studentëve ashtu edhe atë të zbatimit praktik. Treguesit e matshëm rezultuan të njëjtë me ato të paraqitura në mënyrë të detuar në RVB. Syllabuset e çdo lende/moduli ishin hartuar të plota dhe përbanin të gjithë elementët e kërkuar në RVB.</p> <p><b>Standardët plotësohen tërësisht.</b></p> <p><i>Sugjerime - Lidhur me ndryshimet që do të realizohen në kuadrin e programeve të reja të studimit (në reflektim edhe të rekondimit shtatë të lënë nga KA 'ngritjen e një Klinike për punën më studentët') - mund të shikohet mundësia për të krijuar një modul/lëndë të re 'Klinika Ligjore' për të fuqizuar edhe rolin e organizatës së krijuar për këtë qëllim.</i></p> <p><i>Lënda/moduli 'Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor' sugjerohet të ofrohet si modul i detyrueshëm dhe me më shumë ngarkesë (kredite) me qëllim që të aftësojë studentët në aspekte praktike.</i></p>	

*Lënda 'Të drejtat e Njeriut' sugjerohet të konceptohet si modul më vete për rëndësinë që paraqesin vendimet e GJEDNJ  
Në të ardhmen mund të shikohet edhe mundësia që një pedagog të mund të jepë mësim në lëndë/module ku ka fushën e tij/saj të ekspertizës ose edhe lëndë të tjera të ngjashme.*

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënieς, format e mësimdhënieς, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njojurive të studentëve, metodat e mësimdhënieς, teknologjitet e mësimdhënieς, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënieς, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Procesi i mësimdhënieς në programin e studimit BSc në Drejtësi në Kolegjin 'Wisdom' është rregulluar nga Rregullorja e Sh.L.U.J 'Wisdom University'. Duke qënë program bazë studimi BSc në Drejtësi, mësimdhënia relazohet në formën klasikë nëpërmjet **lekcioneve** dhe **seminareve**, megjithatë nga takimi me studentët e programit si dhe nga pedagogët, dhe bazuar edhe në aktet e miratuara për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe sigurimin e cilësisë, u informuam se teknikat klasike të mësimdhënieς pasurohen me **teknika të reja**, të cilat janë më të përshtatshme edhe për moshën e studentëve dhe formimin e tyre si detyra kursi, raste apo casuse praktike për zgjidhje, diskutime në klasë për çështje ligjore si edhe improvizime/simulime të procesit gjyqësor. Qëllimi kryesor i këtyre teknikave është nxitja e mendimit kritik tek studentët, aftësimi i tyre në raste konkrete/praktike si dhe zhvillimi i aftësive komunikuese, punës në grup, debatit, profesionalizmit, pavarësisë në zhvillimin e ideve dhe paraqitjes së tyre, etj. Pedagogët përgjatë modulit aplikojnë edhe teknika të vlerësimit të ndërmjetëm dhe me komponentë, në mënyrë që vlerësimi përfundimtar për modulin të jetë real, të pasqyrojë të gjithë elementët e temave të trajtuara dhe të zbulojë e vlerësojë në spekter të gjerë formimin e studentëve. Në Fakultetin e Drejtësisë u verifikua nga vizita në institucion se gjenden të gjitha lehtësitë e nevojshme të teknologjisë kompjuterike në çdo auditor ku zhvillohen leksionet si dhe në disa salla seminaresh, për të mundësuar përdorimin e prezantimeve në Power Point.

Për t'u njojur me institucionet dhe punën në to, si dhe për të njojur studentët me tregun e punës, institucioni/Kolegji ka nënshkruar marrëveshje me institucion shtetërore dhe private që studentët të kryejnë **praktikën mësimore** në to. Praktika mësimore kryhet në drejtimin e një pedagogu udheheqës/drejtues i cili orienton studentët dhe udhëzon ata për të përgatitur një relacion të punës në institucion. Praktika mësimore është një komponent që vlerësohet njësoj si të gjitha lëndët e tjera.

Në përfudim të moduleve të parashikuara nga programi mësimor, studenti ka mundësi të përfundojë studimet e tij me hartimin e punimit të diplomës - Institucioni për këtë qëllim ka miratuar edhe Rregulloren 'Mbi standartet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave për studimet e ciklit të parë 'bachelor', e vitit 2011. Në përfundim të studimeve, studenti duhet të marrë 180 kredite në mënyrë që studimet në programin BSc në Drejtësi të konsiderohen të kryera.

Lidhur me procesin e mësimdhënieς, konstatuam se ai plotëson standartet formale të parashikuara në Rregulloren e Sh.L.U.J 'Wisdom University'; gjithashtu nga verifikimi në vend i registrave mësimorë dhe takimet e zhvilluarame studentët dhe pedagogët rezultoi se procesi mësimor është zhvilluar sipas programit dhe orarit të miratuar.

Nga vizita në institucion dhe nga takimet me studentët dhe pedagogët, rezultoi një tendencë e perfshirjes së studentëve në aktivitete debati si dhe në kërkimin shkencor, duke i bërë pjesë e diskutimeve dhe prezantimeve. Gjithashtu studentët nga ana e tyre na informuan se periodikisht mblidhen për të diskutuar në klube studentore nën drejtimin apo udheheqjen e një pedagogu efektiv, i cili moderon debatin, orienton studentët për të kryer kërkime ligjore dhe koordinon pjesëmarrjen e tyre.

Lidhur me procesin e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimin e lëndëve, Rregullorja e Sh.L.U.J 'Wisdom University' ka parashikuar kritere të posacme. Procesi i ekuivalentimit kryhet nga departamentet dhe Fakulteti i Drejtësisë; për këtë qëllim ngrihet një komision me vendim të Rektorit. Kërkesa e studentit për transferimin e studimeve së bashku me listën e notave dhe syllabuset e lëndëve depozitohen në sekretarinë mësimore. Dokumentacioni i plotë i përcillet Dekanit të Fakultetit dhe më pas komisionit të ekuivalentimit pranë departamenteve, i cili bën vlerësimin e lëndëve sipas planeve dhe programeve mësimore të Sh.L.U.J 'Wisdom University', transferimin e krediteve dhe të vlerësimeve si dhe bën propozimin për regjistrimin e studentit në vitin ku duhet të vijojë aplikanti dhe detyrimet plotësuese që ai duhet të shlyejë.

**Si konkluzion i përgjithshëm mund të thuhet se gjendja e verifikuar në institucion përputhet me të dhënat e deklaruara në RVB të hartuar nga institucioni.**

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Llojet e Formave të mësimdhënieς, për lëndët/modulet:
  - Leksione
  - Seminarë
  - Ushtrime
  - Laboratore
  - Praktikë lëndore
  - Praktikë profesionale
  - Etj
- Format e kontrollit të njohurive
- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

## **9. Studentët**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Kolegji Universitar 'Wisdom' ka 252 studentë të regjistruar për herë të parë dhe 227 të transferuar nga IAL të tjera, pra gjithsej 479 studentë ndërkohe që 43 studentë janë larguar - këto të dhëna u verifikuan për priudhën 2011-2017 dhe rezultuan të njëjta me ato të paraqitura në RVB.

Në vitin akademik 2014-2015 rezultojnë 49 studentë; në vitin akademik 2015-2016 rezultojnë 64 studentë dhe në vitin akademik 2016-2017 rezultojnë 32 studentë. Gjithsej në këtë program studimi aktualisht gjatë tre viteve akademike rezultojnë 145 studentë

Studentët në programin e studimit BSc në Drejtësi të Kolegjit Universitar 'Wisdom University', u konstatua se pranohen në bazë të kritereve dhe procedurave të



parashikuara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi të nxjerra nga MAS. Gjithashtu, Institucioni/Kolegji ka miratuar edhe rregulla të posacme për pranimin, regjistrimin dhe transferimin e studentëve, të parashikuara nga Rregullorja e Sh.L.U.J 'Wisdom University' (*për më shumë informacion shiko Kreun V të Rregullores - 'Pranimi, regjistrimi dhe transferimi i studentëve'*).

Institucioni pranon kërkuesat e kandidatëve që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në ciklin e parë të studimeve<sup>4</sup>. Ndërkohë që u informuam se për vitin akademik 2016-2017 me Vendim Senati nr. 16, dt. 15.02.2016, janë miratuar mënyrat e vlerësimit për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë BSc të tilla si:

- Nota mesatare e shkollës së mesme, (për të gjithë vitet) do të përbëjë 70% të vlerësimit përfundimtar.
- Nota mesatare e grup lëndëve të vlerësuara si më të rëndësishme nga Komisioni Përzgjedhës, *ad hoc* i cili ngrihet për çdo njësi kryesore dhe *përbën 20 % të vlerësimit përfundimtar.*
- Intervista me çdo kandidat, e organizuar nga Komisioni Përzgjedhës, ad hoc dhe përbën 10% të vlerësimit përfundimtar.

Lidhur me procesin e transferimit (mobilitetit) të studentëve nga IAL të tjera dhe ekuivalentimin e lëndëve, Rregullorja e Sh.L.U.J 'Wisdom University' ka parashikuar kritere të posacme. Procesi i ekuivalentimit kryhet nga departamentet dhe Fakulteti i Drejtësisë; për këtë qëllim ngrihet një komision me vendim të Rektorit. Kërkesa e studentit për transferimin e studimeve së bashku me listën e notave dhe syllabuset e lëndëve depozitohen në sekretarinë mësimore. Dokumentacioni i plotë i përcillet Dekanit të Fakultetit dhe më pas komisionit të ekuivalentimit pranë departamenteve, i cili bën vlerësimin e lëndëve sipas planeve dhe programeve mësimore të Sh.L.U.J 'Wisdom University', transferimin e krediteve dhe të vlerësimeve si dhe bën propozimin për regjistrimin e studentit në vitin ku duhet të vijojë aplikanti dhe detyrimet plotësuese që ai duhet të shlyejë.

Lidhur me të dhënat për numrin e studentëve të regjistruar në vitin e parë, të studentëve të diplomuar dhe atyre të transferuar ato rezultuan të njëjta me të dhënat dhe tabelën e paraqitur ne RVB. Ndërkohë që të dhënat e tjera lidhur me numrin e të punësuarve në pëputhje me diplomën ose jo me diplomën, konstatuam se institucioni i disponon këto të dhëna nëpërmjet intervistimit/kontaktimit të një kampioni prej 115 vetësh në raport me 500 studentë të diplomuar, pavarësisht vështirësive për të ndjekur hap pas hapi ecurinë e punësimit të studentëve të diplomuar nga Kolegji.

#### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

- Procedurat e pranimit të studentëve
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve
- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare
- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

<sup>4</sup> Rregullorja parashikon se pranohen kandidatët/aplikantët që: a) Kanë fituar/marrë diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit të vlerësuar të barazvlefshme me të në Shqipëri. Për kandidatët që e kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011 duhet të dorëzojnë Dëftesë pjekurie të Shkollës së Mesme;

b) Vërtetojnë me dokumente zyrtare transferimin nga një shkollë universitarë publike ose Jopublike që ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë tij.

c) Pranojnë të paguajnë tarifën e studimeve.



- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
- Të dhëna për punësimin e studentëve
- Numri total të diplomuarve
- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)
- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
- etj

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standarde/krriteria	Përbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi	Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi të nxjerra nga MAS. Me vendim të Senatit është miratuar mënyra e vlerësimit të kandidatëve për student, por nuk rezulton që të jenë miratuar kritere shtesë.
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;	Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve si dhe të dhënavë të tjera lidhur me programin e studimit, të cilat jepen në mënyrë të detajuar tek Guida e Studentit dhe 'Librat e syllabuseve' të përgatitura nga zyra e kurrikulave.
<b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lende, në përfundim të semestrit;	Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lende/moduli, në përfundim të semestrit nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të miratuar nga Fakulteti, në bashkëpunim me Departamentet dhe NjSCB.
<b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;	Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyra e Burimeve Njerëzore, Karrierës dhe Jetës Studentore Zyra e Burimeve Njerëzore, Karrierës dhe Jetës Studentore informon studentët mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në programin BSc në Drejtësi si dhe për mundësitë për të vazduhar studimet e mëtejshme Master në ciklin e dytë.
<b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.	Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyra e Burimeve Njerëzore, Karrierës dhe Jetës Studentore Zyra e Burimeve Njerëzore, Karrierës dhe Jetës Studentore informon studentët mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në programin BSc në Drejtësi si dhe për mundësitë për të vazduhar studimet e mëtejshme Master në ciklin e dytë.
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;	Kolegji disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë të Programit BSc në Drejtësi
<b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si	Kolegji Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para

dhe largimet para përfundimit tē programit apo mospërfundimin me sukses tē vitit akademiknë tē cilin zhvillohet programi i studimeve;	përfundimit tē programit apo mospërfundimin me sukses tē vitit akademik nē tē cilin zhvillohet programi i studimeve, përfshitë këtu edhe transferimet nga IAL tē tjera.
<b>Kriteri 3</b> Institucion disponon tē dhëna pēr ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit tē programit tē studimeve qē nga pranimi, deri nē diplomim.	Kolegji disponon tē dhëna pēr ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit tē programit tē studimeve qē nga pranimi, deri nē diplomim, përfshirë këtu edhe tē dhëna pēr punësimin e tyre bazuar nē diplomën/formimin e marrë nga programi BSc nē Drejtësi.

#### **Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij pēr përkujdesjen ndaj studentëve.**

<b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata nē çështjet qē kanë tē bëjnë me procesin mësimor;	Kolegji u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata pēr tē gjitha çështjet qē kanë tē bëjnë me procesin mësimor nēpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore, Karrierës dhe Jetës Studentore Kolegji, nēpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore, Karrierës dhe Jetës Studentore orienton/ndihmon studentët nē përzgjedhjen e institucionit nē tē cilin ata do tē zhvillojnë praktikën profesionale nēpërmjet informimit pēr marrëveshjet e lidhura me institucionet publike dhe private si dhe pēr profilin e punës qē ata kanë.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni (nēpërmjet zyrës pēr këshillimin e karrierës) ndihmon studentët nē përzgjedhjen e institucionit nē tē cilin ata do tē zhvillojnë praktikën profesionale, nē rastet kur parashikohet një e tillë.	

#### **Konkluzionet e GVJ**

Studentët nē programin e studimit BSc nē Drejtësi tē Kolegji Universitar 'Wisdom University', u konstatua se pranohen nē bazë tē kritereve dhe procedurave ligjore, (Liqji Nr. 80/2015 "Pēr Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor nē Institucionet e Arsimit tē Lartë nē Republikën e Shqipërisë"; ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Pēr arsimin e lartë nē Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nēnligjore nē fuqi tē nxerra nga MAS). Institucioni/Kolegji me vendim tē Senatit ka miratuar edhe mënyrën e vlerësimit tē kandidatëve pēr studente me qëllim qē tē rrisë cilësinë e studentëve tē pranuar nē ciklin e parë tē studimeve BSc nē Drejtësi.

Institucioni/Kolegji disponon tē dhëna pēr numrin e studentëve tē regjistruar nē vitin e parë, tē studentëve tē diplomuar dhe atyre tē transferuar, tē dhëna tē plota statistikore, dosjet e plotësuar pēr secilin student tē transferuar/larguar si dhe tē dhëna pēr numrin e tē punësuarve nē pëputhje ose jo me diplomën.

Studentët informohen paraprakisht nē mënyrë tē detajuar pēr programet e studimeve - Institucioni/Kolegji ka hartuar broshura informative ('Guidën e Studentit' dhe 'Librin e Syllabuseve'). Ndërkohë përgjatë gjithë procesit mësimor pedagogët dhe zyrat e mbështetjes së studentëve nē universitet, i orientojnë studentët, ndjekin ecurinë e tyre dhe japidin këshillim pēr zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave qē lidhen me procesin mësimor dhe praktikën.

#### **Në këtë kontekst, tē gjitha standardet e përcaktuara përbushen plotësisht.**

Sugerojmë qē nē tē ardhmen Institucioni tē përcaktojë edhe kritere shtesë pēr pranimin e studentëve nē rritje tē cilësisë.



## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Termë reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Për qëllime të organizimit të kërkimit shkencor, Fakulteti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar Wisdom ka krijuar Njësinë e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Kjo njësi drejton dhe koordinon kërkimin shkencor midis departamenteve të Fakultetit të Drejtësisë si edhe raporton për të gjitha zhvillimet në këtë fushë. Më konkretisht kjo njësi merret me organizimin e konferencave, leksioneve të hapura, seminareve, simpoziumeve, botimeve shkencore, pjesëmarrja në trajnime etj.

Në përgjithësi puna individuale e secilit prej anëtarëve të pesonelit akademik, publikohet në Revistën e Fakultetit "Wisdom" e cila del rregullisht dy herë në vit. Për këtë Revistë nga ana e institucionit arsimor na është vënë në dispozicion Rregullorja përkatëse e cila është ngarkuar edhe në platformën elektronike ASCAL. Kjo Revistë funksionon me bord shkencor i cili është ngritur me vendim të Senatit Akademik, si edhe është e paisur me ISSN. Faqja e parë për cdo numër rezulton se është publikuar në faqen e internetit të Kolegit, por nuk rezulton që të jetë publikuar, të paktën edhe tabela e përbajtjes për secilin numër. Sugjerojmë që në këtë rast të bëhet publike edhe tabela e përbajtjes me qëllim rritjen e interesit, jo vetëm për studentet e Kolegit por edhe për persona të tjerë të cilët realizojnë kërkim shkencor.

Kolegji organizon rregullisht edhe Konferanca Shkencore me karakter Kombëtar dhe Ndërkombëtar. Një pjesë e këtyre Konferencave përmenden edhe në RVB. Kjo tregon për një jetë aktive akademike. Një pjesë e këtyre konferencave kanë shërbyer edhe për stafin akademik, me qëllim rritjen e kualifikimit të tyre akademik dhe plotësimin e kritereve për marrjen e gradave/titujve shkencorë. Po kështu në këto Konferanca kanë marrë pjesë dhe janë përfshirë edhe studentë të Kolegit të cilët kanë prezantuar materialet e tyre. Këto konferanca janë realizuar edhe në bashkëpunim me institucione të tjera të administratës publike, si edhe në disa raste edhe me institucione ndërkombëtare. Këtu mund të përmendim institucione dhe organizma të tilla si Qendra Ndërkombëtare për studime ligjore në Austri, Ministria e Integrimit, Ministria e Turizmit, Ministria e Mjedisit, Dhomë Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë, shtëpi botuese të ndryshme etj.

Nga intervista në institucion nuk rezultoi që për realizimin e konferencave shkencore të kishte akte që rregullonin, organizimin dhe funksionimin e tyre. Për këtë arsyе sugjerojmë



që një rregullore e tillë të hartohe dhe të miratohet, ku të gjejnë pasqyrim, mënyra e organizimit të këtyre konferencave, ngritja e bordit shkencor, thirrjet për pjesëmarrje, mënyra e vlerësimit të kumtesave dhe e botimit të tyre etj. Një pjesë e këtyre konferencave janë publikuar edhe në faqen e internetit të Kolegji, por vetëm faqa e parë nga ku rezulton përbërje a bordit shkencor dhe jo tabela e përbajtjes. Sugerojmë që në këtë rast të bëhet publike edhe tabela e përbajtjes me qëllim rritjen e interesit, jo vetëm për studentet e Kolegji por edhe për persona të tjerë të cilët realizojnë kërkim shkencor.

Një tjetër element pozitiv në fushën e kërkimit shkencor është edhe fakti që Kolegji, mbështet personelin e vetë akademik në realizimin e botimeve me karakter shkencor. Në RVB përmenden disa të tilla. Kjo mundëson zhvillimin e mëtejshëm të kërkimit shkencor, i cili në këtë formë shfaqet edhe më i thelluar. Nga intervista në institucion, megjithatë, nuk rezultoi që për realizimin e këtyre botimeve të kishte akte që rregullonin, mënyrën e paraqithjes së tyre, rregullat e drejtëshkrimit, përbëjen dhe detyrat e bordit shkencor që vlerëson rëndësinë shkencore të botimit etj. Për këtë arsyе sugerojmë që një rregullore e tillë të hartohe në të ardhmen. Po kështu, sugerojmë që edhe lista e këtyre botimeve, sebashku me tabelën e përbajtjes të publikohet në faqen e internetit të institucionit me qëllim njohjen e tyre në botën akademike si edhe për personat e tjerë, studies të këtyre fushave.

Nga RVB rezulton se nga Fakulteti i Drejtësisë i Kolegji Universitar Wisdom organizohet edhe seminare me tematika të caktuara, workshope si edhe leksione të hapura, me pedagogë të huaj të cilët trajtojnë tema të caktuara. Edhe këto organizime ndihmojnë në zhvillimin e kërkimit shkencor, si edhe në gjallërimin e jetës akademike në institucion.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për kërkimin shkencor
- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL
- Numri i projekteve kërkimore të situara
- Numri i projekteve të zbatuara
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor
- Numri i Çmimive Kombëtare
- Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

Në mënyrë të përbledhur të dhënat për aktivitete e mësipërme janë pasqyruar në ankesin 8 të këtij raporti.

Nga materialet e paraqitura, si edhe nga intervista në institucion rezulton se për zhvillimin e mëtejshëm të kërkimit shkencor është krijuar edhe Institut për kërkim dhe zhvillim

Wisdom, por i cili ende nuk është bërë funksional, pasi ka nevojë për plotësimin e tij me staf akademik, administrativ por edhe drejtues. Për këtë arsyе sugjerojmë zhvillimin sa më të shpejtë të këtij instituti.

## **11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Kolegji Universitar Wisdom ka lidhur rreth 35 marrëveshje bashkëpunimi me institucione të administratës publike, zyra avokatie dhe ndërmjetësimi si edhe me institucione arsimore të huaj. Kjo i shërben rritje dhe kualifikimit të stafit akademik si edhe dhënier e mundësive të shumta për zhvillimin dhe thellimin e njohurive tek studentët.

Në kuadër të bashkëpunimit, Fakultetin e Drejtësisë e kanë vizituar personalitete dhe lektorë të ndryshëm vendas dhe të huaj. Po kështu, realizimi i këtyre marrëveshjeve ka krijuar mundësinë që studentët të zhvillojnë praktikë mësimore në vende të ndryshme duke rritur aftësitë e tyre praktike në zbatim të ligjit.

Të rëndësishme janë marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të huaja. Këto mundësojnë shkëmbimin e përvojave midis stafeve akademike dhe dhënier e përvojave të reja për studentët. Në këtë drejtim rezulton se janë zhvilluar shumë leksione të hapura më lektorë të huaj, veçanërisht me lektorë që vijnë nga CILS` Qendra Ndërkombëtare për studime ligjore në Austri. Realizimi i këtyre leksioneve rezulton që të jetë i organizuar dhe tematikat për të cilat flasin lektorët e huaj janë gjithmonë të ndryshme, duke rritur në këtë mënyrë larmishmërinë e debatit juridik edhe në një këndvështrim kahasimor.

Përsa i përket aktiviteve shkencore, për një pasqyrë më të detajuar referojuni ankesit 10, ndërsa përsa i përket marrëveshjeve të bashkëpunimit, referojuni ankesit 11 të këtij raporti.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
  - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
  - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
  - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
  - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
  - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Dokumentacioni përkatës

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standaret/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Informacioni shkëmbhet rregullisht midis anëtarëve të personelit akademik, si edhe ka një bashkëpunim të mirë, i cili rezulton i dukshëm nga organizimi i konferencave, simpoziumeve, botimeve në Revistën e Fakultetit etj. Ka një ndarje të detyrave midis anëtarëve të personelit akademik e cila mundëson marrjen e përgjegjësive dhe garanton bashkëpunimin midis stafit akademik. Po kështu drejtuesit e departamenteve kanë përgjegjësi të qarta në nxitjen dhe vlerësimin e kërkimit shkencor nga stafet e tyre akademike.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;	Nga ana e Kolegji Universitar, ka një sërë marëveshjes më qëllim realizimin e praktikës së studentëve. Këto përfshijnë si institucione të administratës publike, ashtu edhe zyra avokatie, noterie etj. Marrëveshjet e bashkëpunimit me punëdhënësit, rezultojnë që janë të frytshme përsa i përket rritjes se aftësisë dhe zhvillimit të njojurive të studentëve në fushat përkatëse.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;	Nga ana e Fakultetit të Drejtësisë, organizohen seminare me punonjës praktike, në të cilat marrin pjesë edhe studentë. Kjo ndihmon në zhvillimin e njojurive të tyre, por nuk ka një plan të mirëfilltë organizimi të trajnimeve profesionale në bashkërendim me punëdhënësit.
<b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnimë profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;	Rregullisht nga strukturat e Fakultetit, hartohen raporte analitike në funksion të programeve të studimit.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analistik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	
<b>Konkluzionet e GVJ</b>	
Fakulteti i Drejtësisë i Kolegji Universitar Wisdom, ka krijuar sistem të ndryshme të shkëmbimit të informacionit midis stafit akademik dhe studentëve. Po kështu janë të ndara përgjegjësit midis drejtuesve të departamenteve dhe Dekanit të Fakultetit për nxitjen dhe koordinimin e këtij bashkëpunimi.	
Institucioni ka marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me institucione të amdinistratës publike, zyra avokatie, ndërmjtësimi etj, si edhe me institucione të huaja, të cilat	



mbështesin dhe ndihmojnë realizimin e programave të studimit. Këto bashkëpunime kanë ndihmuar në realizimin e praktikës mësimore, kryerjen e aktiviteve akademike dhe shkencore si edhe realizimin e trajnimeve profesionale.

**Në këtë këndvështrim standardet plotësohen.**

## **ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Lidhur me Rekomandimet që Këshilli i Akreditimit i ka lënë Institucionit/Kolegjit Universitar 'Wisdom' në akreditimin e parë, gjatë vizitës në institucion si dhe gjatë takimeve të zhvilluara me autoritetet drejtuese, me pedagogët, studentët dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, bazuar edhe nga inspektimi i dokumentacionit dhe vizita në ambientet e institucionit, rezultoi se janë marrë masa pozitive dhe stafi ka punuar seriozisht për të plotësuar të gjitha rekomandimet.

Lidhur me rekomandimin e parë 'vlerësimi i mundësisë së rritjes së kontakteve edhe me universitetë të tjera, vendase dhe të huaja, publike dhe private' u konstatua se janë nëshkruar marrëveshje me institucion e arsimore (IAL) vendase dhe të huaja si dhe janë zhvilluar aktivitete konkrete, ndaj vlerësohet se ky rekomandim është përbushur.

Lidhur me rekomandimin e dytë 'rishikimi i kritereve të punësimit të pedagogëve të rinj me synim nxitjen dhe mbajtjen e tyre në punë përfatë të gjata kohore' institucioni dhe departamentet janë të motivuar jo vetëm të punësojnë pedagogë të kualifikuar që kanë kapacitetin akademik (tituj dhe gradat) por fokusohen edhe në ndihmesën konkrete që i kanë dhënë pedagogëve të rinj për të plotësuar kriteret e kualifikimeve shkencore.

Lidhur me rekomandimin e tretë 'krijimi/rishikimi i mundësive për të vendosur kriterë seleksionuese në pranimin e studentëve në programet e studimit Bachelor në funksion të rritjes së cilësisë' u konstatua se kriteret për pranimin e studetëve janë kryesisht ligjore.

Përpos tyre Kolegji në RVB vlerëson se ka vendosur kriterë shtesë në sensin e detajimit të kritereve ligjore. Nga analiza e tyre rezulton që me vendim të Senatit është rregulluar vetëm mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve për studentë, por nuk rezulton që të jenë vendosur kriterë shtesë, tej atyre të përcaktuara me akte nënligjore. Në këtë këndvështrim arritëm në përfundimin se ky rekomandim nuk është plotësuar.

Lidhur me rekomandimin e katërt 'mundësia e pasurimit të fondit të bibliotekës me botime në gjuhën shqip dhe në gjuhë të huaja sipas fushave të studimit' u konstatua se Kolegji ka bërë përpjekje serioze për të pasuruar fondin e bibliotekës me botime të reja dhe botime në gjuhën shqipe, pwrfsfirw abonimin në bibliotekën elektronike ProQuest. U konstatua një tendencë dhe interes për të studiuar në thellësi, çështje që lidhen me vlerat, historinë dhe trashëgiminë e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri (në këtë kuadër vlen të përmendet

*monografia nē proces botimi me titull "Trashëgimia Institucionale e Shqipërisë prej antikitetit deri nē vitin 1920), ndaj ky rekomandim ẽshtë plotësuar.*

Lidhur me rekomandimin e pestë 'mundësia e organizimit të një jete më aktive dhe të gjallë të studentëve pas mësimit' studentët kanë filluar të organizohen nē forume apo klube ku diskutojnë çështje të ndryshme ligjore dhe kanë organizuar udhëtime dhe aktivitete të përbashkëta argëtuese. Ata kanë pasur edhe mbështetjen e Kolegit për këtë qëllim, ndaj ky rekomandim ẽshtë plotësuar.

Lidhur me rekomandimin e gjashtë 'zgjidhjen e cështjes së kampusit' gjatë vizitës nē institucion u konstatua së mjediset e reja të Kolegit ishin tejet të përshtatshme për procesin mësimor e të pajisuara me teknologji bashkëkohore, ambiente për pedagogët, bibliotekën, ambiente shplodhëse për studenët, hapësira të gjelbëruara dhe mundësi parkimi, ndaj rekomandimi ẽshtë plotësuar plotësisht.

Lidhur me rekomandimin e shtatë 'ngritjen e një Klinike për punën më studentët' ẽshtë krijuar Klinika Ligjore e Kolegit, megjithatë ẽshtë nē fazat e para të veprimtarisë së saj, e për rrjedhojë nuk ka arritur të krijojë synimin e vendosur për të realizuar aspektin praktik të punës me studentët apo edhe këshillim logjor *pro bono*. Në këtë kontekst, rekomandimi ẽshtë plotësuar pjesërisht, ndaj sugjerojmë që drejtuesit e programit BSC nē Drejtësi të angazhojnë ekspertë nē ngritjen e kapaciteteve të Klinikës Ligjore për ta bërë atë funksionale dhe nē shërbim praktik të studentëvë të ciklit të parë por edhe për programet e ciklit të dytë, dhe pse jo edhe nē shërbim të komunitetit me asistencë ligjore *pro bono* për kategori qytetarësh që nuk kanë mundësi të përballojnë finansiarisht kostot e një procesi ligjor.

## **II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

RVJ për programin e studimit BSc nē Drejtwsi të Kolegit Universitar Wisdom mbyllet me analizën përmbledhëse të RVJ, sipas metodës SWOT (*Strength – pikat e fortë, Weakness – pikat e dobëta, Opportunities – mundësitë, Threats – pengesat*).

### **Pikët e fortë**

- a) Programet e studimit janë hartuar nē përputhje me kërkuesat e legjislacionit nē fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor si edhe me Kartën e Bolonjës. Programet e studimit janë hartuar bazuar nē përvojën akademikë më të mirë vendase dhe të huaj. Nëpërmjet botimeve shkencore synohet gjithmonë përmirësimi i literaturës nē funksion të këtyre programeve. Programet e studimit i janë nështruar përmirësimit të vazhdueshëm.
- b) Punësimi i personelit akademik me kohë të plotë realizohet nëpërmjet procedurave transparante dhe të rregullta. Stafi akademik me kohë të plotë mbulon pjesën më

të madhe të ngarkesës mësimore dhe përbëhet nga personel me grada/tituj shkencorë që janë pnuësuar që nga fillimi (*hapja*) e Kolegjit.

- c) Institucioni ndjek një politikë mbështetjeje për kualifikimin shkencor të personelit akademik.
- d) Mësimdhënia dhe kërkimi shkencor monitorohen vazhdimisht nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë e cila ka ngritur një mekanizëm kontrolli të vazhdueshëm dhe periodik.
- e) Institucioni ofron literaturë të nevojshme në gjuhën shqipe për zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjithahstu institucioni ka krijuar akses për stafin akademik dhe studentët në librarinë elektronike ProQuest me mbi 10.000 tituj.
- f) Institucioni disponon hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për procesin e mësimdhënieς dhe stafin.
- g) Institucioni ka treguar qendrueshmëri financiare, si edhe aplikon një sistem kontrolli auditit të brendshëm dhe të jashtëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- h) Institucioni ka një bazë të plotë të dhënavë për studentët (*numrin e studentëve të regjistruar, të transferuar, të diplomuar, dosjet personale opër secilin student si edhe të dhëna për studentët e diplomuar në BSc në Drejtësi*).
- i) Institucioni zhvillon vazhdimisht konferanca shkencore dhe veprimtari të tjera akademike dhe profesionale.
- j) Institucioni boton rregullisht Revistën Winsdom, e paisur me ISSN, materialet e referuar në konferanca si edhe materiale studimore të personelit akademik.
- k) Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera (arsimore vendase dhe të huaja, institucionë të administratës shtetërore, zyra avokatie dhe noterie) të cilat shërbejnë për rritjen e cilësisë në mësimdhënie.

#### Pikët e dobëta

- a) Të ardhurat financiare bazohen vetëm në tarifat që paguhen nga ana e studentëve, si edhe mungojnë mundësitë për gjenerimin e fondeve nga burime të tjera.
- b) Faqja zyrtare e internetit të isntitucionit, nuk pasqyron të plotë të gjithë informacionin e për veprimtarinë e Kolegjit.
- c) Megjithëse është krijuar, ende nuk është bërë funksionale 'Klinika e ligjit'
- d) Po kështu nuk është ende funksional 'Instituti për kërkim dhe zhvillim Wisdom' (*i cili mund të zhvillojë kërkim shkencor të mirëfilltë dhe të aplikojë për projekte të ndryshme*).

#### Mundësítë

- a) Rritja e pjesëmarrjen nëpër projekte të ndryshme, e cila do të aktvizojë si stafin akademik ashtu edhe vetë studentët.
- b) Rritjen e alternativave për financimin e institucionit, nëpërmjet projekteve por edhe në realizimin e shërbimeve për të tretët.

- c) Shfrytëzimi i mundësive që ofron legjislacioni i ri për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

#### Pengesat

- Konkurenca me IAL të tjera, publike dhe jopublike, duke sjellë si pasojë largimin e personelit akademik dhe të studentëve.
- Numri i lartë i universitetetve të ndryshme të cilat ofrojnë këtë program studimi mund të ulë interesin e kandidatëve për studentë në këtë fushë.
- Mungesa e burimeve financiare alternative.

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

**Dr. Erind Merkuri**

**Prof. Asoc. Dr. Mirela P. Bogdani**

